

Kumbona e së Diellës



Papa Piu XII

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.7/8, Korrik - Gusht 2024

PIU XII, PROFETI I PAQES, NË TMERRIN E LUFTËS

Fjalët e Papës Pacelli, transmetuar nga Radio Vatikani në mbrëmjen e 24 gushtit 1939, tetëdhjetë e pesë vjet më parë, jehojnë ende të fuqishme. Nuk i përkasin të shkuarës, por janë më të gjalla e më aktuale se kurrë. Janë thirrje për ta ndalur fundin e tmerrshëm, para se të jetë tepër vonë. "Drejtësia e hap rrugën me forcën e arsyes, jo me armë! Rreziku është i pashmangshëm, por ka ende kohë. Asgjë nuk humbet me paqe. Gjithçka mund të humbasë me luftë".

Atë mbrëmje të 24 gushtit 1939, tetëdhjetë e pesë vjet më parë, ajri ishte i rëndë, klaustrofobik, por nuk ishte vapa e verës: në të vërtetë Papa Piu XII nuk do t'i kishte vënë re të gjitha këto lojëra stinore, i shtypur nga ankthi i një luftë gjithnjë e më të afërt. "Asgjë nuk humbet me paqen. Çdo gjë mund të ndodhë me luftën. Lërimi burrat ta kuptojnë përsëri njëri-tjetrin. Le të fillojmë përsëri negociatat. Duke biseduar me vullnet të mirë dhe respekt për të drejtat e njëri-tjetrit, do ta kuptojnë se negociatat e sinqerta dhe efektive nuk përjashtohen kurrë nga sukcesi i ndershëm".

Nga Castel Gandolfo, radiomesazhi i Pacellit drejtuar qeverive dhe popujve në rrezikun e afërt të luftës, i transmetuar nga mikrofonat e Radio Vatikanit, jehon edhe sot, sikur të ishte paralajmërim i përhershëm kundër fatkeqësive të një konflikti që nuk i përket më një kohe të kaluar, por që përsëritet vazhdimisht, deri në kohët tona, përhapet në çdo cep të botës, kërcënon indiferencën e ngurtë të botës perëndimore, pa kujtesë dhe pa përvojë. Dëgjojmë fjalët e përzemërta të Papës dhe ndjejmë të njëjtin ankth, por edhe të njëjtin hidhërim, sepse duket se historia nuk na ka mësuar gjë prej gjëje.

R.SH. / Vatikan





Papa Françesku NJË FE TË RRËNJOSUR NË HYJIN QË U BË NJERI	4
Papa Françesku PËR TË NDËRTUAR DIÇKA TË MIRË NË KOHËN TONË	6
KKIE KRISHTI ËSHTË SHPRESA E VETME PËR NJERIUN	10
Papa Françesku SHPRESO E VEPRO BASHKË ME KRIJIMIN	12
Imzot Angelo Massafra OFM FÉ E ATDHË MBETI HALLKA E PASHKËPUTUR	15
Mons. Luigi Bonazzi MBETËT PËRGJITHNJË NË KUJTESËN E NJERËZVE	16
Salvator Kurti ME NJË DASHURI TË MADHE PËR KRISHTIN	17
Don Lush Gjergji LUFTA VETËMOHUESE KUNDËR SËMUNDJEVE E VARFËRISË	18
Mt. Rita Ndoci ITINERARE KATEKUMENTALE PËR JETËN MARTESORE	20
Dom Jetmir Nikolli MISTER TË MADH PËRMBAN SAKRAMENTI I MARTESËS	21
Imzot Angelo Massafra OFM NUK MUND TË MOS GËZOHEMI E TË FALËNDEROJMË ZOTIN	22
Imzot Angelo Massafra OFM PËRVOJË NË GJURMËT E MARTIRËVE	23
Kronisti DOM FABIO CASSOL	24
Kronisti TEMA PËR FAMILJE NË SHOQËRINË TONË SHQIPTARE	25
Kronisti KEMI MEDITUAR FJALËN E ZOTIT	25
Dom Nikë Ukgjini ARBËRORËT TË VENDOSUR NË MES TË DY KULTURAVE	26
Dr. Paulin Marku ABAT PREND DOÇI	28
Kronisti SHËN BARTOLOMEU	31
Redaksia VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVII, nr. 7/8 (580 - 581) Korrik - Gusht 2024

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



NJË FE TË RRËNJOSUR NË HYJIN QË U BË NJERI!

*Vizita baritore e Atit të Shenjtë Françeskut në Trieste
me rastin e javës së pesëdhjetë sociale të katolikëve në Itali*

*Sheshi "Unità d'Italia" të Triestes
E diel, më 7 korrik 2024*

Pretku i Papa Françeskut

Për ta rizgjuar shpresën e zemrave të thyera dhe për t'i mbështetur njerëzit gjatë vështirësive të udhëtimit, Hyji gjithmonë ka dërguar profetë mes popullit të tij. Megjithatë, siç na tregon Leximi i Parë i sotëm, duke na treguar ngjarjet e Ezekielit, ata shpesh gjetën një popull rebel, «njerëzit, të të cilët po të dërgoj, janë kokëfortë e zemërgur» (Ez 2, 4), dhe ata u refuzuan prej tyre.

Edhe Jezusi bën të njëjtën përvojë si profetët. Kthehet në Nazaret, në atdheun e tij, mes njerëzve me të cilët u rrit, por nuk njihet, madje refuzohet: «erdhi ndër të vetët, e të tija nuk e pranuan» (Gjn 1, 11). Ungjilli na thotë se Jezusi «u bë për ta arsye e mosbesimit në të» (Mk 6, 3), por fjala «shkandull» nuk i referohet diçkaje të turpshme ose të pahijshme siç e përdorim ne sot; shkandull do të thotë «pengesë», diçka që të bllokton dhe të ndalon të shkosh më tej. Le ta pyesim veten: cila është pengesa që na ndalon të besojmë në Jezusin?

Duke dëgjuar fjalët e bashkëfshatarëve të tij, shohim se ato ndalen vetëm në historinë e tij tokësore, në origjinën e tij familjare dhe, për rrjedhojë, ata nuk janë në gjendje të shpjegojnë se si nga djali i Jozef zdruckthëtarit, domethënë nga një person i zakonshëm, të dalë kaq shumë urti dhe madje edhe aftësia për të bërë mrekulli. Shkandulli, pra, është fakti që Jezusi është njeri. Pengesa që i ndalon këta njerëz që të njohin praninë e Hyjit në Jezusin është fakti se Ai është njeri, është thjeshtë i biri i Jozef zdruckthëtarit: si mundet Hyji, gjithëpushtetshmi, të zbulohet në brishtësinë e mishit të një njeriu? Si mundet një Hyj i gjithëpushtetshëm dhe i fortë, i cili krijoi tokën dhe liroi popullin e tij nga skllavëria, ta bëjë veten të dobët deri në atë pikë sa të vijë në mish dhe të përkulet për të larë këmbët e nxënësve të vet? Ky është shkandulli.

Vëllezër dhe motra, një fe e bazuar në një Hyj njerëzor, që ulet drejt njerëzimit, që kujdeset për të, që preket nga plagët tona, që lodhjen tonë e merr

mbi vete, që thyhet si buka. Një Hyj i fortë dhe i fuqishëm, që është në anën time dhe më kënaq në çdo gjë është tërheqës; një Hyj i dobët, një Hyj që vdes në kryq nga dashuria dhe gjithashtu më kërkon të kapërcej çdo egoizëm dhe të dhuroj jetën time për shpëtimin e botës; dhe ky, o vëllezër e motra, është një shkandull.

E megjithatë, duke e vënë veten përpara Zotit Jezus dhe duke parë sfidat që na sfidojnë, për problemet e shumta sociale dhe politike të diskutuara gjithashtu në këtë Javë Sociale, për jetën konkrete të popullit tonë dhe përpjekjet e tij, mund të themi se sot na duhet pikërisht ky shkandull.





Kemi nevojë për shkandullin e fesë. Nuk kemi nevojë për një religjiozitet të mbyllur në vetvete, që e ngre shikimin drejt qiellit pa u shqetësuar për atë që ndodh në tokë dhe kremton liturgji në tempull duke harruar pluhurin që rrjedh nëpër rrugët tona. Përkundrazi, na duhet *shkandulli i fesë* – kemi nevojë për *shkandullin e fesë* - një fe të rrënjësuar në Hyjin që u bë njeri dhe, si rrjedhim, një fe njerëzore, një fe prej mishi, që hyn në histori, që përkëdhel jetën e njerëzve, që shëron zemrat e thyera, që bëhet tharmi i shpresës dhe filiz i një bote të re. Është një fe që zgjon ndërgjegjet nga plogështia, që vendos gishtin në plagë, në plagët e shoqërisë - të cilat janë të shumta -, një fe që ngre pikëpyetje për të ardhmen e njeriut dhe të historisë; është një fe e paqetë dhe ne kemi nevojë për një jetë të paqetë, një fe që lëviz nga zemra në zemër, një fe që merr problemet e shoqërisë, një fe të paqetë që ndihmon për të kapërcyer mediokritetin dhe përtacinë e zemrës, e cila bëhet një gjemb në mish të një shoqërie shpesh të anestezuar dhe të trullësuar nga konsumizmi. Dhe do të ndalem pak këtu... Thuhet se shoqëria jonë është pak e anestezuar dhe e trullësuar nga konsumizmi: a keni menduar, ju vetë, nëse konsumizmi ju ka hyrë në zemër? Ankthi për të pasur, për të pasur gjëra, për të pasur më shumë, ankthi për të harxhuar para pa kriter. Konsumizmi është një plagë, është një kancer: ta sëmurë zemrën, të bën egoist, të bën të shikosh vetëm veten tënde. Vëllezër dhe motra, mbi të gjitha, kemi nevojë për një fe që asgjëson llogaritë e egoizmit njerëzor, që denoncon të keqen, që drejton gishtin kah padrejtësitë, që shqetëson komplotet e atyre që, nën hijen e pushtetit, luajnë mbi lëkurën e të dobët. Dhe sa, sa – e dimë – e përdorin fenë për t'i shfrytëzuar njerëzit. Kjo nuk është fe.

Një poet nga ky qytet, duke përshkruar në një lirikë kthimin e tij të zakonshëm në shtëpi në mbrëmje, shprehet se po kalon një rrugë disi të errët, një vend degradimi ku njerëzit dhe mallrat e portit janë “skarco”, domethënë mbeturina të njerëzimit; e megjithatë pikërisht këtu – shkruan ai – kështu, citoj: «Unë gjej, duke kaluar, të pafundmin në përlulësi», sepse prostituta dhe marinari, gruaja që grindet dhe ushtari, «janë të gjitha krijesa të jetës dhe të dhimbjes; Zoti vepron në to, sikurse në mua» (U. Saba, «Città vecchia», te *Il canzoniere (1900-1954) Edizione definitiva*, Torino, Einaudi, 1961). Të mos e harrojmë këtë: Hyji fshihet në qoshet e errëta të jetës së qytetit tonë, a e keni menduar këtë gjë? Në qoshet e errëta të jetës së qytetit tonë? Prania e saj zbulohet pikërisht në fytyrat e gdhendura nga vuajtja dhe ku

degradimi duket se triumfon. Pafundësia e Hyjit fshihet në mjerimin njerëzor, Zoti trazohet dhe bëhet i pranishëm, dhe bëhet një prani miqësore pikërisht në mishin e plagosur të të fundmëve, të të harruarve, të të skartuarve. Zoti shfaqet atje. Dhe ne, që ndonjëherë shkandullohemi pa nevojë nga shumë gjëra të vogla, do të bënim mirë ta pyesnim veten: pse të mos shkandullohemi kur përballemi me të keqen që po përhapet, me jetën që poshtërohet, me problemet e punës, me vuajtjet e migrantëve? Pse qëndrojmë apatikë dhe indiferentë ndaj padrejtësive të botës? Pse nuk e marrim për zemër situatën e të burgosurve, e cila gjithashtu ngrihet nga ky qytet i Triestes si një britmë ankthi? Pse nuk mendojmë për mjerimin, dhimbjen, humbjen e kaq shumë njerëzve në qytet? Kemi frikë, kemi frikë se gjejmë Krishtin, atje.

Shumë të dashur, Jezusi e jetoi profecinë e jetës së përditshme në mishin e tij, duke hyrë në jetën e përditshme dhe në historitë e njerëzve, duke treguar zemërdhembshuri brenda ngjarjeve dhe kështu ka treguar se është Hyj, që është i dhembshur. Dhe për këtë, dikush është shkandulluar prej Tij, është bërë pengesë, është refuzuar deri në gjyq dhe dënim; megjithatë, Ai i qëndroi besnik misionit të tij, nuk u fsheh pas dykuptimësisë, nuk u pajtua me logjikën e pushtetit politik e fetar. Jetën e tij ia dhuroi Atit. Kështu edhe ne të krishterët: jemi thirrur që të jemi profetë, dëshmitarë të Mbretërisë së Hyjit, në të gjitha situatat që përjetojmë, në çdo vend ku jetojmë.

Vëllezër dhe motra, nga ky qytet i Triestes, me pamje nga Evropa, udhëkryq popujsh dhe kulturash, tokë kufitare, ta ushqejmë ëndrrën e një qytetërimi të ri të themeluar mbi paqen dhe vëllazërimin; ju lutem, të mos shkandullohemi prej Jezusit, por, përkundrazi, të indinjohemi për të gjitha situatat në të cilat jeta shëmtohet, plagoset, vritet; ta mbartim profecinë e Ungjillit në mishin tonë, me zgjedhjet tona më përpara se me fjalët tona. Atë koherencë mes zgjedhjeve dhe fjalëve. Dhe kësaj Kishe të Triestes dua t'i them: përpara! Përpara! Vazhdoni të angazhoheni në rresht të parë për të përhapur Ungjillin e shpresës, veçanërisht ndaj atyre që vijnë nga rruga ballkanike dhe ndaj të gjithë atyre që, në trup apo në shpirt, kanë nevojë të inkurajohen dhe të ngushëllohen. Të angazhohemi së bashku: me qëllim që, duke e rizbuluar veten të dashur nga Ati, të jetojmë si vëllezër të gjithë. Vëllezër të gjithë, me atë buzëqeshjen e mirëseardhjes dhe të paqes së shpirtit.

Faleminderit.



PËR TË NDËRTUAR DIÇKA TË MIRË NË KOHËN TONË!

*Vizita baritore e Atit të Shenjtë Françeskut në Trieste,
me rastin e javës së pesëdhjetë sociale të katolikëve në Itali*

*Qendra e Kongresit “Generali Convention Center” të Triestes
E diel, më 7 korrik 2024*

Fjala e Atit të Shenjtë

*Të nderuara autoritete,
të dashur vëllezër Ipeshkvij,
Zotërinj kardinalë,
vëllezër e motra, mirëmëngjesi!*

Falënderoj Kardinal Zuppi-n dhe Imzot Baturin, të cilët më ftuan që të ndaj këtë seksion të fundit me ju. Përhëndes Imzot Renna-n dhe Komitetin Shkencor dhe Organizativ të Javëve Sociale. Në emër të të gjithëve i shpreh mirënjohje Imzot Trevisi-t për pritjen e Dioqezës së Triestes.

Herën e parë që dëgjova për Triesten ishte nga gjyshi im që kishte bërë ne vitin 1914 në Piave. Ai na mësoi shumë këngë dhe njëra ishte për Triesten: «*Il general Cadorna scrisse alla regina: “Se vuol guardare Trieste, che la guardi in cartolina”*» («Gjenerali Cadorna i shkroi mbretëreshës: “Nëse do ta shikosh Triesten, shikoje në kartolinë”»). Dhe kjo është hera e parë që dëgjoja për këtë qytet.

Kjo ishte Java e Pesëdhjetë Sociale. Historia e “Javëve” është e ndërthurur me historinë e Italisë dhe kjo gjë flet shumë: flet për një Kishë të ndjeshme ndaj transformimeve të shoqërisë dhe që synon të kontribuojë për të mirën e përbashkët. Të forcuar nga kjo përvojë, keni dashur të thelloheni në një temë shumë aktuale: “*Al cuore della*

democrazia. Partecipare tra storia e futuro” (“Në zemër të demokracisë. Pjesëmarrje mes historisë dhe të ardhmes”).

I Lumi Giuseppe Toniolo-ja, i cili e nisi këtë iniciativë në vitin 1907, pohonte se demokracia mund të përkufizohet si «ai rend civil në të cilin të gjitha forcat shoqërore, ligjore dhe ekonomike, në plotësinë e zhvillimit të tyre hierarkik, bashkëveprojnë proporcionalisht me të mirën e përbashkët, duke u kthyer në fund në avantazh mbizotërues të klasave të ulëta» Kështu thoshte Toniolo-ja. Në dritën e këtij përkufizimi, është e qartë se në botën e sotme demokracia, le ta pranojmë, nuk është në gjendje të mirë shëndetësore. Kjo na intereson dhe na shqetëson, sepse e mira e njeriut është në rrezik dhe asgjë që është njerëzore nuk mund të jetë e huaj për ne.

Në Itali, sistemi demokratik e arriti pjekurinë e tij pas Luftës së Dytë Botërore, falë edhe kontributit vendimtar të katolikëve. Mund të krenohemi me këtë histori, e cila u ndikua edhe nga përvoja e Javëve Sociale; dhe, pa e mitizuar të kaluarën, duhet të mësojmë prej saj për të marrë përsipër përgjegjësinë për të ndërtuar diçka të mirë në kohën tonë. Ky qëndrim gjendet në *Shënimin baritor* me të cilin Episkopati Italian riktheu Javët Sociale në





vitin 1988. Po citoj synimet: «T'i japim kuptim angazhimit të secilit për transformimin e shoqërisë; t'i kushtojmë vëmendje njerëzve që mbesin jashtë apo mënjanë proceseve dhe mekanizmave të suksesshëm ekonomikë; t'i japim hapësirë solidaritetit social në të gjitha format e tij; të mbështesim kthimin e një etike që kërkon të mirën e përbashkët [...]; t'i japim kuptim zhvillimit të vendit, të kuptuar [...] si një përmirësim global të cilësisë së jetës, të bashkëjetesës kolektive, të pjesëmarrjes demokratike, të lirisë autentike»[3]. Fundi i citatit.

Ky vizion, i rrënjësuar në Doktrinën Shoqërore të Kishës, përfshin disa dimensione të angazhimit të krishterë dhe një lexim ungjillor të fenomeneve shoqërore, të cilët jo vetëm janë të vlefshëm për kontekstin italian, por përfaqësojnë një paralajmërim për të gjithë shoqërinë njerëzore dhe për udhëtimin e të gjithëve popujve. Në fakt, ashtu si kriza e demokracisë prek realitete dhe kombe të ndryshme, në të njëjtën mënyrë qëndrimi i përgjegjësishëm ndaj transformimeve shoqërore është një thirrje drejtuar të gjithë të krishterëve, kudo që jetojnë dhe punojnë, në çdo vend të botës.

Është një imazh që i përmbledh të gjitha këto dhe që ju keni zgjedhur si simbolin e këtij takimi: *zemrën*. Duke u nisur nga ky imazh, propozoj dy reflektime për të ushqyer rrugëtimin e të ardhmes.

Në të parin mund ta imagjinojmë *krizën e demokracisë* si një *zemër të plagosur*. Ajo që kufizon pjesëmarrjen është para syve tanë. Nëse korrupsioni dhe paligjshmëria tregojnë një zemër “të goditur nga infarkti”, duhet të na shqetësojnë edhe format e ndryshme të përjashtimit social. Sa herë që dikush lihet mënjanë, i gjithë trupi shoqëror vuan. Kultura e skarcos krijon një qytet ku nuk ka vend për të varfërit, të palindurit, të brishtët, të sëmurët, fëmijët, gratë, të rinjtë, të moshuarit. Kjo është kultura e skarcos. Pushteti bëhet vetëreferencial - kjo është një sëmundje e keqe - i paaftë për të dëgjuar dhe për t'u shërbyer njerëzve. Aldo Moro-ja na kujtonte se «një Shtet nuk është vërtet demokratik nëse nuk është në shërbim të njeriut, nëse nuk ka si synim suprem dinjitetin, lirinë, autonominë e personit njerëzor, nëse nuk respekton ato formacione shoqërore në të cilat njeriu zhvillohet lirisht dhe në të cilin ai integron personalitetin e tij». Vetë fjala “demokraci” nuk përkon thjesht me votën e popullit; ndërkohë, mua më shqetëson numri i vogël i njerëzve që kanë shkuar për të votuar. Çfarë do të thotë kjo? Nuk është vetëm vota e popullit, por kërkohet që të krijohen kushtet që të gjithë të shprehen dhe të marrin pjesë. Dhe pjesëmarrja nuk mund të

improvizohet: ajo mësohet në fëmijëri, në rini dhe duhet të “ushetrohet”, edhe në kuptimin kritik në lidhje me tundimet ideologjike dhe populistike. Në këtë këndvështrim, siç pata rastin të kujtoj vite më parë kur vizitova Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës, është e rëndësishme që të theksohet «kontributi që mund të japë *krishterimi* sot në zhvillimin kulturor dhe social evropian në rrethin e një marrëdhënieje korrekte. mes fesë dhe shoqërisë», duke promovuar një dialog të frytshëm me bashkësinë civile dhe me institucionet politike, sepse, duke ndriçuar njëri-tjetrin dhe duke u liruar nga mbeturinat e ideologjisë, mund të fillojmë një reflektim të përbashkët veçanërisht për çështjet që lidhen me jetën e njeriut dhe me dinjitetin e personit.

Ideologjitë janë joshëse. Dikush i krahasonte me atë që i binte flautit në Hamelin; joshin, por nuk të çojnë tjetërkund veçse të mbytesh.

Për këtë qëllim, parimet e solidaritetit dhe të subsidiaritetit mbeten të frytshme. Në fakt, një popull mbahet së bashku nga lidhjet që e përbëjnë atë dhe lidhjet forcohen kur secili prej tyre vlerësohet. Çdo person ka vlerë; çdo person është i rëndësishëm. Demokracia kërkon gjithmonë kalimin nga *anëtarësimi në një parti te pjesëmarrja*, nga “brohoritja” te dialogu. “Për sa kohë që sistemi ynë socio-ekonomik do të prodhojë sërish një viktimitë dhe do të ketë edhe vetëm një person të skartuar, nuk mund të ketë festë të vëllazërisë universale”. Një shoqëri njerëzore dhe vëllazërore është në gjendje të punojë për të siguruar në një mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme që të gjithë të shoqërohen përgjatë rrugës së jetës së tyre, jo vetëm për të siguruar nevojat themelore, por në mënyrë që ata të japin më të mirën, edhe nëse performanca e tyre nuk do të jetë ndër më të mirat, edhe nëse do të ecin ngadalë, edhe nëse efektshmëria e tyre nuk do të jetë e rëndësishme”[6]. Të gjithë duhet të ndihen pjesë e një projekti bashkësior; askush nuk duhet të ndihet i padobishëm. Disa forma *asistencializmi* që nuk e njohin dinjitetin e personave... Po ndalem te fjala *asistencializëm*. *Asistencializmi*, vetëm në këtë mënyrë, është armik i demokracisë, është armik i dashurisë për të tjerët. Dhe disa forma të *asistencializmit* që nuk e njohin dinjitetin e personave janë hipokrizi sociale. Të mos e harrojmë këtë gjë. Dhe çfarë qëndron pas këtij distancimi nga realiteti shoqëror? Ka *indiferencë*, dhe indiferenca është një kancer i demokracisë, një mospjesëmarrje.

Reflektimi i dytë është një inkurajim *për të marrë pjesë*, në mënyrë që demokracia t'i ngjajë një



zemre të shëruar. Është kjo: më pëlqen të mendoj se në jetën shoqërore është shumë i nevojshëm shërimi i zemrave, shërimi i zemrave. Një zemër e shëruar. Dhe për këtë duhet të ushtrojmë krijimtarinë. Nëse shikojmë përreth, shohim shumë shenja të veprimit të Shpirtit Shenjt në jetën e familjeve dhe të bashkësive. Edhe në fushat e ekonomisë, të ideologjisë, të politikës dhe të shoqërisë. Të mendojmë për ata që kanë krijuar hapësirë brenda një aktiviteti ekonomik për personat me aftësi të kufizuara; për punëtorët që kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për të parandaluar largimin nga puna të punëtorëve të tjerëve; për bashkësitë e energjisë së rinovueshme që promovojnë ekologjinë integrale, duke u kujdesur gjithashtu për familjet në varfëri energjetike; për administratorët që favorizojnë lindjet, punën, shkollën, shërbimet edukative, shtëpitë e aksesueshme, lëvizshmërinë për të gjithë, integrimin e emigrantëve. Të gjitha këto gjëra nuk futen në një politikë pa pjesëmarrje. Zemra e politikës është pjesëmarrja. Dhe këto janë gjërat që bën pjesëmarrja, kujdesi për gjithçka; jo vetëm bamirësi, duke u kujdesur për këtë..., jo: për gjithçka!

Vëllazëria i bën marrëdhëniet shoqërore të lulëzojnë; dhe nga ana tjetër, kujdesi për njëri-tjetrin kërkon guximin të mendosh si popull. Duhet guxim ta mendosh veten si popull dhe jo si unë apo si klani im, familja ime, miqtë e mi. Fatkeqësisht, kjo kategori - "popull" - shpesh keqinterpretohet dhe "mund të çojë në eliminimin e vetë fjalës "demokraci" ("qeverisja e popullit"). Sidoqoftë,

për të pohuar se shoqëria është më shumë se shuma e thjeshtë e individëve, është i domosdoshëm termi "popull" që nuk është populizëm. Jo, është diçka tjetër: populli. Në fakt, «është shumë e vështirë që të projektosh diçka të madhe në planin afatgjatë nëse nuk arrihet të bëhet një ëndërr kolektive». Një demokraci me zemër të shëruar vazhdon të kultivojë ëndrra për të ardhmen dhe të bëjë thirrje për përfshirje personale e bashkësiore. Ta ëndërrojmë të ardhmen. Mos kini frikë.

Të mos gënjejemi nga zgjidhjet e lehta. Të apasionohemi për të mirën e përbashkët. Kemi për detyrë që të mos e manipulojmë fjalën demokraci dhe as ta shtrembërojmë me tituj bosh për nga përmbajtja, të aftë për të justifikuar çdo veprim. Demokracia nuk është një kuti boshe, por është e lidhur me vlerat e personit, të vëllazërisë dhe gjithashtu edhe të ekologjisë integrale.

Si katolikë, në këtë horizont, nuk mund të kënaqemi me një fe private. Kjo do të thotë jo aq shumë të dëgjoresh, por sidomos të kesh guximin për të bërë propozime drejtësie dhe paqeje në debatin publik. Kemi diçka për të thënë, por jo për të mbrojtur privilegje. Jo. Duhet të jemi zë, zë që denoncon dhe propozon në një shoqëri shpesh pa zë, ku shumë nuk kanë zë. Shumë, shumë nuk kanë zë. Shumë. Kjo është dashuri-bamirësi politike, e cila nuk mjaftohet me trajtimin e efekteve, por përpigjet t'u bëjë ballë shkaqeve. Kjo është dashuri-bamirësi politike. Është një formë dashurie-bamirësie që i lejon politikës që të jetë në lartësinë e përgjegjësive të saj dhe të largohet nga polarizimet,



polarizime këto që varfërojnë dhe nuk ndihmojnë për t'i kuptuar dhe për t'i përballuar sfidat. Krejt bashkësia e krishterë është e thirrur në këtë dashuri-bamirësi politike, në dallimin e mbarështimeve dhe të karizmave. Ta formojmë veten në këtë dashuri, për ta vënë atë në qarkullim në një botë që nuk ka pasion civil. Duhet ta rimarrim pasionin civil, këtë, të politikanëve të mëdhenj që kemi njohur. Të mësojmë më shumë dhe më mirë që të ecim së bashku si popull i Hyjit, për të qenë një tharm pjesëmarrjeje mes njerëzve pjesë e të cilit jemi. Dhe kjo është një gjë e rëndësishme në veprimin tonë politik, qoftë edhe të barinjve tanë: njohja e popullit, afrimi me popullin. Një politikan mund të jetë si një bari që shkon para popullit, mes popullit dhe pas popullit. Para popullit për të treguar pak rrugën; mes njerëzve, të ketë nuhatjen e popullit; pas popullit për të ndihmuar ata që ecin më ngadalë. Një politikan që nuk e ka nuhatjen e popullit është një teoricien. I mungon themeli.

Giorgio La Pira kishte menduar për protagonizmin e qyteteve, të cilat nuk kanë pushtetin të bëjnë luftëra, por që paguajnë çmimin më të lartë për to. Kështu ai imagjinoi një sistem "urash" mes qyteteve të botës për të krijuar mundësi bashkimi dhe dialogu. Duke ndjekur shembullin e La Pira-s, laikëve katolikë italianë nuk duhet t'u mungojë kjo aftësi "për të organizuar shpresën". Kjo është puna juaj, organizimi. Organizimi edhe i paqes dhe i projekteve të mira politike që mund të lindin nga poshtë. Pse të mos rifillojmë, t'i mbështesim dhe t'i shumëfishojmë përpjekjet për një formim social dhe politik që nis nga të rinjtë? Pse të mos ndajmë pasurinë e mësimin shoqëror të

Kishës? Mund të parashikojmë vende për diskutim dhe dialog dhe të promovojmë sinergji për të mirën e përbashkët. Nëse procesi sinodal na ka stërvitur në shohitjen bashkësiore, horizonti i Jubileut na shikoftë aktivë, shtegtarë të shpresës, për Italinë e të nesërmes. Si nxënës të të Ngjallurit, të mos ndalojmë kurrë së ushqyeri besimin, të sigurt se koha është më lart sesa hapësira. Të mos e harrojmë këtë gjë. Shumë herë mendojmë se puna politike ka të bëjë me marrje hapësire: jo! Ka të bëjë me vënie bast në kohë, me nisjen e proceseve, jo me marrjen e vendeve. Koha është më lart sesa hapësira dhe të mos harrojmë se nisja e proceseve është më e mençur sesa zënia e hapësirave. Ju porosis që në jetën tuaj shoqërore të kenë guximin të nisni procese, gjithmonë. Është krijimtari dhe gjithashtu është ligj i jetës. Një grua, kur lind një fëmijë, fillon të nisë një proces dhe e shoqëron atë. Të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe ne në politikë.

Ky është roli i Kishës: të përfshijë në shpresë, sepse pa të administrohet e tashmja, por nuk mund të ndërtohet e ardhmja. Pa shpresë, do të ishim administratorë, ekuilibristë të së tashmes dhe jo profetë dhe ndërtues të së ardhmes.

Vëllezër dhe motra, ju falënderoj për angazhimin tuaj. Ju bekoj dhe uroj që të jeni artizanë të demokracisë dhe dëshmitarë nxitës pjesëmarrjeje. Dhe ju kërkoj me përvujtëri që të luteni për mua, sepse kjo punë nuk është e lehtë. Faleminderit.

Tani, të lutemi së bashku dhe do t'ju jap bekimin. Recitimi i lutjes Ati ynë.





KRISHTI ËSHTË SHPRESA E VETME PËR NJERIUN!

*Asambleja Plenare e Këshillit të Konferencave
Ipeshkvore të Evropës, dt. 24-27 qershor 2024*

Beograd, më 27 qershor 2024

Asambleja Plenare e Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Evropës me titull “Shtegtarë të shpresës. Për një Kishë Sinodale dhe misionare”, u zhvillua në Beograd nga data 24 deri me datën 27 qershor 2024, me ftesë të Shkëlqesisë së Tij Imzot Ladislav Nemet-it, arqipeshkëv i Beogradit dhe nënkryetar i Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Evropës (KKIE).

Punimet, të cilat filluan me përshëndetjet e arqipeshkëvit të Beogradit dhe të nuncit apostolik në Serbi, Shkëlqesisw sw Tij Imzot Santo Gangemi-t, vijuan me një shqyrtim të situatës në Evropë, përshkruar në raportet e Shkëlqesisë së Tij Imzot Mariano Crociata-s, ipeshkëv i Latinës dhe president i Komisionit të Konferencave Ipeshkvore të Bashkimit Evropian; të Shkëlqesisë së Tij Imzot Noël Treanor-it, nunc apostolik pranë Bashkimit Evropian; të Imzot Marco Ganci-t,

vëzhgues i Selisë së Shenjtë pranë Këshillit të Evropës. Dhe me ndërhyrjet e presidentëve të Komisioneve të KKIE-së, të cilët prezantuan aktivitetet dhe programin e komisioneve të tyre.

Në fjalën e tij, Shkëlqesia e Tij Imzot Gintaras Grušas-i, arqipeshkëv i Vilniusit dhe president i KKIE-së, kujtoi hapjen e selisë së re të KKIE-së në Romë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të ipeshkvijve evropianë mes tyre dhe me Selinë e Shenjtë, si edhe për tw dhënë një shtysë të re baritore dhe një zell ekumenik, veçanërisht nw vitin jubilar dhe gjatw ecjes sinodale.

Në përgatitje të seksionit të dytë të Sinodit për sinodalitetin, presidenti Grušas u fokusua në rolin që mund të kenë Organizmat kontinentalë dhe Konferencat Ipeshkvore për të jetuar dhe për t'u rritur në sinodalitet. Prezantoi gjithashtu iniciativat në fushën ekumenike që po zhvillon KKIE-ja:





përditësimin e Kartës Ekumenike Evropiane, nënshkruar së bashku me Konferencën e Kishave Evropiane në vitin 2001, që në versionin e saj të ri duhet të nënshkruhet të dielën e Mëshirës Hyjnore të vitit 2025, vit në të cilin data e Pashkës përkon për të gjithë të krishterët; dhe takimin e parë me Këshillin Drejtues të Konferencës së Përhershme të Kishave Ortodokse Lindore në Evropë.

Në fund, i ftoi të gjithë që të përgatiten për Jubileun e afërt, në mënyrë që të jetë një ngjarje hiri për bashkësitë dhe vendet tona, si dhe një mundësi për të dëshmuar se Krishti është shpresa e vetme për njeriun.

Hirësia e Tij Kardinal Robert Francis Prevost-i, prefekt i Dikasterit për Ipeshkvijtë, mbajti një raport me temë “Dimensioni i Ungjillizimit dhe misioni i Kishës në Evropë”, duke marrë nxitje nga ngjarjet e javëve të fundit dhe duke filluar nga zgjedhjet evropiane e krizat btoërore, të cilat përfshijnë luftën në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme.

Çelësi, për prefektin e Dikasterit për ipeshkvijtë, duke u nisur nga vizioni agustinian i kohës, është shikimi i mishërimit të Jezusit, i cilit duhet të jetohet në kremtimin eukaristik, dhe futja e tij në jetën e përditshme, duke u kujdesur për të varfrit, për emigrantët, për ata që kanë nevojë, por sidomos “duke vënë në jetë mënyrën e të dashuruarit të Jezu Krishtit”.

I Nderuari Prof. Josef Sayer-i, teolog i baritores,

mbajti një fjalim mbi *Preedicate Evangelium. Pasojat dhe implikimet për Konferencat Ipeshkvnore dhe Organizmat Kontinentalë*. Duke analizuar tekstin e kushtetutës së re apostolike të shpallur nga Papa Françesku në vitin 2022, e cila rregullon funksionet dhe detyrat e organeve të Kuries, profesor Sayer-i prezantoi rolin e ri të Konferencave Ipeshkvnore, me të cilat dikasteret kuriale do të thirreshin të ndërlihdeshin me më shumë rregullsi, duke mirëpritur edhe disa iniciativa.

Gjatë punimeve, u zgjodh si Sekretar i ri i Përgjithshëm i KKIE-së, për një mandat pesëvjeçar, i Nderuari Antonio Ammirati, deri tani zëvendës sekretar i përgjithshëm dhe zëdhënës i KKIE-së. Ai zë vendin e të Nderuarit Martin Michaliček-ut, sekretar i përgjithshëm që nga viti 2018. Ipeshkvijtë i shprehën mirënjohjen e tyre Don Martin-it për gatishmërinë e tij dhe për punën e bërë vitet e fundit në shërbim të Kishave në Evropë.

Domethënës ishte takimi i anëtarëve të KKIE-së me Patriarkun e Kishës Ortodokse Serbe, Shenjtërinë e tij Porfirije.

Më 21 shtator 2024, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Paqes, ipeshkvijtë do të rinovojnë ftesën për t'u lutur për viktimat e luftës dhe për të thirrur paqen për Ukrainën, Tokën e Shenjtë dhe Sudanin. Asambleja e ardhshme Plenare do të mbahet në Lisbonë, nga data 8 deri me datën 10 tetor 2025.





SHPRESO E VEPRO BASHKË ME KRIJIMIN

*Mesazhi i Shenjtërisë së tij Papa Françesku
për ditën botërore të lutjes për kujdesin ndaj krijimit
Romë, dt. 1 shtator 2024*

Të dashur vëllezër e motra!

“Shpreso e vepro bashkë me krijimin”: është tema e Ditës së Lutjes për Kujdesin ndaj Krijimit, 1 shtatorin e ardhshëm. I referohet Letrës së Shën Palit drejtuar Romakëve 8,19-25: Apostulli është duke sqaruar se çfarë do të thotë të jetosh sipas Shpirtit dhe përqendrohet në shpresën e sigurt të shpëtimit me anë fese, që është jeta e re në Krishtin.

1. Le të nisemi atëherë nga një pyetje e thjeshtë, por që mund të mos ketë një përgjigje lehtësisht të kuptueshme: kur jemi vërtet besimtarë, *si ndodh që ne besojmë?* Nuk është aq për faktin se “ne besojmë” në diçka transhendente të cilën arsyeja jonë nuk arrin ta kuptojë, misteri i paarritshëm i një Hyji të largët, të padukshëm dhe të patregueshëm. Përkundrazi, do të thoshte Shën Pali, ne besojmë sepse *Shpirti Shenjt banon në ne*. Po, ne jemi besimtarë sepse vetë Dashuria e Hyjit «u ndikua në zemrat tona» (Rom 5,5). Prandaj, Shpirti është tani, realisht, «pengu i trashëgimit tonë» (Ef 1,14), si një për-thirrje [*provocazione*] për të jetuar gjithmonë të prirë drejt të mirave të amshuara, *sipas plotësisë së njeriut të bukur e të mirë që është Jezusi*. Shpirti Shenjt i bën besimtarët, veprues në dashuri. Ai i vendos ata në një ecje të vyer drejt lirisë shpirtërore, e cila gjithsesi bashkëmbart luftën mes logjikës së botës dhe logjikës së Shpirtit, të cilat kanë fryte të kundërta (Gal 5,16-17). E dimë tanimë, se fryti i parë i Shpirtit, që i përmbledh të gjitha frytet e tjera, është dashuria. Prandaj, të udhëhequr nga Shpirti Shenjt, besimtarët janë bij të Hyjit dhe mund t'i drejtohen Atij duke e quajtur «Abba, Atë» (Rom 8,15), pikërisht si Jezusi, në lirinë e atyre që nuk bien më në frikën e vdekjes, sepse *Jezusi është ngjallur prej së vdekurish*. Ja shpresa e madhe: dashuria e Hyjit ka fituar, fiton gjithmonë dhe do të fitojë përsëri. Pavarësisht nga perspektiva e vdekjes fizike, për njeriun e ri që jeton në Shpirtin Shenjt, caku i lavdisë është tashmë i sigurt. Kjo shpresë nuk zhgënjën, siç na kujton edhe *Bula e shpalljes së Jubileut të ardhshëm*.

2. Ekzistenca e të krishterit është një jetë feje, vepruese në dashuri dhe plot e përplot me shpresë, në pritje të kthimit të Zotërisë në lavdinë e tij. Nuk është

problem “vonesa” e paruzisë, e ardhjes së tij të dytë. Çështja është një tjetër: «Kur të vijë Biri i njeriut, a thua do të gjejë fe mbi tokë?» (Lk 18,8). Po, feja është dhuratë, fryt i pranisë së Shpirtit në ne, por është gjithashtu një *detyrë*, që duhet kryer lirisht, në bindje ndaj urdhrit të dashurisë së Jezusit. Ja shpresa e lume që duhet dëshmuar: ku? kur? si? Brenda *dramave të vuajtjes në mishin njerëzor*. Nëse dikush ëndërron, tani duhet të *ëndërrojë duke i mbajtur sytë e hapur*, të gjallëruar nga vizioni i dashurisë, i vëllazërisë, i miqësisë dhe i drejtësisë për të gjithë. *Shpëtimi i krishterë hyn në qenësinë e dhimbjes së botës*, që prek jo vetëm njerëzit, por mbarë universin, vetë natyrën, *oikos-in* e njeriut, mjedisin e tij jetësor; e rrok krijimin si një “parajsë tokësore”, tokë mëmë, e cila do duhej të ishte një *vend gëzimi dhe premtim lumturie për të gjithë*. Optimizmi i krishterë mbështetet mbi një shpresë të gjallë: ai e di se çdo gjë priret drejt lavdisë së Hyjit, drejt përmbushjes fundore në paqen e tij, në ringjalljen trupore në drejtësi, “nga lavdia në lavdi”. Mirëpo, gjatë kohës që kalon, ne bashkëndajmë dhimbje e vuajtje: *mbarë krijesa rënkon* (krh. Rom 8,19-22), të krishterët rënkojnë (krh. rr. 23-25) dhe vetë Shpirti rënkon (krh. rr. 26-27). *Rënkimi shpreh shqetësim dhe vuajtje, bashkë me mallin dhe dëshirën*. Rënkimi shpreh *besim në Hyjin dhe mbështetje në shoqërimin e tij dashamirës dhe kërkues, në funksion të realizimit të planit të tij, që është gëzimi, dashuria dhe paqja në Shpirtin Shenjt*.

3. I gjithë krijimi është i përfshirë në këtë proces të një lindjeje të re dhe, duke rënkuar, pret lirim: bëhet fjalë për një rritje të fshehtë që piqet, pothuajse si “fara e sinapit që bëhet pemë e madhe” ose si “tharmi në brumë” (krh. Mt 13,31-33). Fillimet janë fare të vogla, por rezultatet e pritura mund të jenë të një bukurie të rrallë. Duke qenë pritje e një lindjeje – zbulimi i bijve të Hyjit – *shpresa është mundësia për të qëndruar të palëkundur në mes të vështirësive*, për të mos u shkurajuar në kohë mundimesh ose përballë barbarisë njerëzore. *Shpresa e krishterë nuk zhgënjën, por as nuk gënjen*: nëse rënkimi i krijimit, i të krishterëve dhe i Shpirtit është hershim dhe pritje e



shpëtimit tashmë në veprim, tani jemi të zhytur në shumë vuajtje që Shën Pali i përshkruan si “vështirësi, ngushticë, salvim, uri, zhveshësi, rrezik, shpatë” (krh. Rom 8,35). Atëherë shpresa është një lexim alternativ i historisë dhe i ngjarjeve njerëzore: jo gënjes, por realist, i realizmit të fesë që sheh të padukshmen. Kjo shpresë është *pritja me durim, sikurse mos-parja e Abrahamit*. Më pëlqen ta kujtoj atë vizionar të madh fetar që ishte Gioacchino da Fiore, abati kalabrez, i cili, sipas Dante Aligierit, ishte “i dhuntisur me shpirt profetik”: në një kohë betejash të përgjakshme, konfliktesh midis Papatit dhe Perandorisë, Kryqëzatash, herezish dhe mondaniteti të Kishës, diti të tregonte idealin e një *shpirti të ri të bashkëjetesës* mes njerëzve, të shënjuar nga vëllazëria universale dhe paqja e krishterë, fryt i një Ungjilli të jetuar. Unë e kam parashtruar këtë shpirt të miqësisë sociale dhe vëllazërisë universale në letrën enciklike “*Të gjithë vëllezër*”. Dhe kjo harmoni midis njerëzve duhet të shtrihet edhe te krijimi, në një “antropocentrizëm të mbështetur” (krh. *Laudate Deum*, 67), mbi përgjegjësinë për një *ekologji njerëzore dhe integrale*, që është rrugë shpëtimi për shtëpinë tonë të përbashkët dhe për ne që jetojmë në të.

4. Përse gjithë kjo e keqe në botë? Përse kaq shumë padrejtësi, kaq shumë luftëra vëllavrasëse që shkaktojnë vdekjen e fëmijëve, që shkatërrojnë qytete, ndotin mjedisin jetësor të njeriut, tokën mëmë, të përdhunuar e të shkatërruar? Duke iu referuar në mënyrë të nënkuptuar mëkatit të Adamit, Shën Pali thotë: «Sepse e dimë: mbarë krijesa rënkon

dhe vuan në dhimbjet e lindjes deri tani» (*Rom 8,22*). Lufta morale e të krishterëve lidhet me “rënkimin” e krijesës, sepse «është e nënshtruar kotësisë» (rr. 20). Mbarë kozmosi dhe çdo krijesë rënkon dhe dëshiron “me padurim”, që të tejkalohet gjendja e tanishme dhe të rivendoset ajo zanafillore: njëmend, lirimi i njeriut bashkëmbart edhe lirimin e të gjitha krijesave të tjera që, në solidarësi me kushtet njerëzore, janë vënë nën zgjedhën e skllavërisë. Ashtu si njerëzimi, krijimi – pa fajin e vet – është skllavëruar dhe e shih veten të paaftë për të bërë atë për çka është krijuar, domethënë për të pasur një domethënie dhe synim të qëndrueshëm; ai gjendet i nënshtruar ndaj shpërbërjes dhe vdekjes, të rënduara edhe më shumë nga abuzimi i njeriut ndaj natyrës. Por, në kuptimin e kundërt, shpëtimi i njeriut në Krishtin është shpresë e sigurt edhe për krijimin: njëmend, «edhe vetë krijesa do të lirohet nga skllavërimi i shkatërrimit për të pasur pjesë në lirinë dhe lumturinë e bijve të Hyjit» (*Rom 8,21*). *Kështu që, në shëlbimin e Krishtit është e mundur të soditet me shpresë lidhja e solidarësisë midis qenieve njerëzore dhe të gjitha krijesave të tjera*.

5. Në pritjen shpresëdhënëse dhe këmbëngulëse për kthimin e lavdishëm të Jezusit, Shpirti Shenjt e mban syhapur bashkësinë fetare dhe e udhëzon vazhdimisht, e thërret për një kthim të stilit të jetës, për t'i rezistuar degradimit njerëzor të mjedisit dhe për të shpërfaqur atë kritikë sociale që është para së gjithash dëshmi e mundësisë së ndryshimit. Ky kthim qëndron në kalimin nga arroganca e atyre që duan të sundojnë mbi të tjerët dhe mbi natyrën – e zvogëluar



kjo në një objekt që manipulohet – në përvujtërinë e atyre që kujdesen për të tjerët dhe krijimin. «Një qenie njerëzore që pretendon të zëvendësojë Hyjin bëhet rreziku më i keq i vetvetes» (*Laudate Deum*, 73), sepse mëkati i Adamit i ka shkatërruar marrëdhëniet themelore me të cilat njeriu jeton: atë me Hyjin, me vetveten, me qeniet e tjera njerëzore dhe me kozmosin. Të gjitha këto marrëdhënie duhet, në mënyrë sinergjike, të rivendosen, të shpëtohen, të “bëhen të drejta”. Asnjëra prej tyre nuk mund të mungojë. Nëse njëra mungon, dështojnë të gjitha.

6. *Të shpresosh e të veprësh bashkë me krijimin* do të thotë para së gjithash të bashkohësh forcat dhe, duke ecur së bashku me të gjithë burrat dhe gratë vullnetmirë, të kontribuosh «për rimendimin e çështjes së pushtetit njerëzor, për domethënien dhe kufijtë e tij. Njëmend, pushteti ynë është rritur furishëm në vetëm disa dekada. Kemi bërë përparime teknologjike mbresëlënëse dhe befasuëse, por njëkohësisht jemi bërë shumë të rrezikshëm, të aftë për të vënë në rrezik jetën e shumë qenieve dhe vetë mbijetesën tonë» (*Laudate Deum*, 28). Një pushtet i pakontrolluar përfton përbindësia dhe kthehet kundër vetvetes. Prandaj, sot, është urgjente të vendosen kufij etikë në zhvillimin e Inteligjencës artificiale, e cila me kapacitetin e saj përlllogaritës dhe simulues mund të përdoret për të sunduar mbi njeriun dhe natyrën, në vend që të vihet në shërbim të paqes dhe zhvillimit integral (krh. *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2024*).

7. «Shpirti Shenjt na shoqëron në jetë»: fëmijët, djem e vajza, të mbledhur në sheshin e Shën Pjetrit për Ditën e tyre të parë botërore, që përkojnë me të dielën e Trinisë së Shenjtë, e kuptuan mirë këtë gjë. Hyji nuk është një ide abstrakte e pafundësisë, por është Atë i dashur, Bir mik e shëlbues i çdo njeriu dhe Shpirti Shenjt që i udhëheq hapat tanë në rrugën e dashurisë. Bindja ndaj Shpirtit të dashurisë *ndryshon rrënjësisht qëndrimin e njeriut*: nga “grabitqar” në “kultivues” të kopshtit. *Toka i është besuar njeriut, por ajo mbetet e Hyjit* (krh. *Lev 25,23*). Ky është antropocentrizmi teologjik i traditës hebraike-kristiane. Prandaj, të pretendosh që ta zotërosh dhe ta sundosh natyrën, ta manipulosh atë sipas dëshirës vetjake, është një formë idhujtarie. Është njeriu prometeian, i dehur nga pushteti i tij teknokratik, i cili, me arrogancë, e shpie tokën në një gjendje “të pahirshme”, pra pa hiri e Hyjit. Tani, nëse hiri i Hyjit është Jezusi, i vdekur e i ngjallur, është e vërtetë ajo

që thoshte Benedikti XVI: «Nuk është shkenca ajo që e shëlbbon njeriun. Njeriu shëlbbohet përmes dashurisë» (*Let. enc. Spe salvi*, 26), dashurisë së Hyjit në Krishtin, nga e cila asgjë dhe askush nuk mund të na ndajë askurrë (krh. *Rom 8,38-39*). Krijimi, i tërhequr vazhdimisht nga e ardhmja e tij, nuk është statik ose i mbyllur në vetvete. Sot, edhe falë zbulimeve të fizikës bashkëkohore, lidhja midis materies dhe shpirtit paraqitet në njohuritë tona në një mënyrë gjithnjë e më magjepsëse.

8. Mbrojtja e krijimit është, pra, një çështje përveçse etike edhe teologjike në shkallën më të lartë: njëmend, ka të bëjë me ndërthurjen mes misterit të njeriut dhe atij të Hyjit. *Ky mister mund të thuhet se është “lindës”, meqenëse lidhet me aktin e dashurisë me të cilin Hyji krijon qenien njerëzore në Krishtin. Ky akt krijues i Hyjit dhuron dhe themelon të vepruarit e lirë të njeriut dhe krejt eticitetin e tij: i lirë pikërisht në të qenit i krijuar sipas shëmbëllimit të Hyjit që është Jezu Krishti, dhe, për këtë arsye, “përfaqësues” i krijimit në vetë Krishtin. Ekziston një motivim transhendent (teologjik-etik) që e angazhon të krishterët të promovojë drejtësinë dhe paqen në botë, edhe nëpërmjet caktimit universal të të mirave: bëhet fjalë për zbulimin e bijve të Hyjit që krijimi pret, duke rënëkuar, si në dhembjet e lindjes. Në çështje nuk është vetëm jeta tokësore e njeriut në këtë histori, por mbi të gjitha fati i tij i amshimit, *eschaton*-i i lumnisë sonë, Parajsja e paqes sonë, në Krishtin Zotin e kozmosit, të Kryqëzuarin-e Ngjallur nga dashuria.*

9. Të shpresosh e të veprësh bashkë me krijimin atëherë do të thotë të jetosh një fe të mishëruar, e cila di të depërtojë në mishin e vuajtur dhe shpresues të njerëzve, duke bashkëndarë pritjen e ngjalljes trupore për të cilën besimtarët janë të paracaktuar në Krishtin Zot. Në Jezusin, Biri i amshuar në mishin njerëzor, ne jemi përnjëmend bij të Atit. Me anë të fesë dhe pagëzimit, fillon për besimtarin jeta sipas Shpirtit (krh. *Rom 8,2*), një jetë e shenjtë, një ekzistencë si bir i Atit, si Jezusi (krh. *Rom 8,14-17*), sepse, në saje të pushtetit të Shpirtit Shenjt, Krishti jeton në ne (krh. *Gal 2,20*). Një jetë që bëhet këngë dashurie për Hyjin, për njerëzimin, me dhe për krijimin dhe që e gjen plotësinë e vet në shenjtëri.

**Romë, Shën Gjoni në Lateran, 2
7 qershor 2024.
FRANÇESKU**



FÉ E ATDHË MBETI HALLKA E PASHKËPUTUR

Inaugurimi i Monumentit në nder të Kardinal Mikel Koliqi Shkodër 29.06.2024

*I nderuar Nunci Apostolik në Shqipëri
Imzot Luigi Bonazzi
Të nderuar Deputetë e Autoritete Lokale
Të nderuara Familje Koliqi e Kurti
Vëllezër e Motra të pranishëm*

Kardinali Mikel Koliqi, ishte një nga figurat më të ndritura të Kishës katolike shqiptare, u bë simbol i persekutimit të katolikëve dhe popullit shqiptar gjatë regjimit komunist, dëshmitar i gjakut të martirëve, derdhur për Fé e Atdhé në rrethana rrënjëthënëse e tejet tragjike, nën diktaturën komuniste ateiste në Shqipëri.

Nuk është e thjeshtë të përmbledhësh me pak fjalë jetën e kardinalit Mikel Koliqi, një nga figurat më poliedrike në historinë e Kishës katolike të Shqipërisë

Lindi në Shkodër. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, për t'i vijuar studimet në Milano të Italisë, ku edhe u diplomua në Universitetin e Milanos. Ishte në moshë të pjekur, kur ndjeu thirrjen për rrugën meshtarake, thirrje që e kurorëzoi duke u shuguruar meshtar më 30 maj 1931. U kthye menjëherë në Atdhé dhe nisi shërbimin, më parë si ndihmës-famullitar, e pastaj si famullitar i katedrales së Shkodrës.

U shqua edhe për veprimtarinë e tij muzikore e publicistike. Muzikoi melodramat e para në historinë e muzikës shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë me Dom Ndrë Zadejën. Qe kryeredaktor i revistës "Kumbona e së Dieles". Gjatë regjimit komunist u burgos tri herë dhe u dënua me 40 vjet heqje lirie.

Papa Shën Gjon Pali II e emëroi prelat nderi (monsinjor) në janar 1992, e takoi personalisht gjatë vizitës së tij në Shkodër, më 25 prill 1993 dhe e krijoi kardinal më 26 nëntor 1994 në Vatikan, 30 vite më parë.

Në pak rreshta një jetë të veçantë siç qe ajo e dom



Mikel Koliqit, që shtrihet në gjithë hapësirën e shekullit të kaluar, një jetë e jashtëzakonshme për Fé e Atdhé që mbeti hallkë e pashkëputur nga tmerri i persekutimit ateist të komunizmit.

E jeta dhe veprimtaria e kardinalit Mikel Koliqi qe dhe është për të gjithë shqiptarët shembull e testament shpirtëror e kombëtar, pra, një udhërrëfyes për të gjithë ne, se si duhet punuar. të bashkuar e në mirëkuptim, për një të ardhme më të mirë për popullin e vendin, me një përkushtim e përvujtëri, duke kërkuar e përvetësuar gjithmonë vlerat e vërteta e të shëndosha, njerëzore, shoqërore e shpirtërore e, kulturore e kombëtare.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë personat që kanë kontribuar në realizimin e këtij busti të vendosur pranë oborrit të Katedrales sonë, pranë ambienteve të famullisë ku ai shërbeu.

Një falënderim për Familjen Kurti, për nipin e Tij, të ndjerin z. Abert Kurti i të cilin e takova disa ditë përpara se të ndërronte jetë. Ai ishte shumë entuziast për këtë vepër, e tani besoj se nga parajsja gëzon me ne të gjithë.

Po ashtu dhe z. Salvator Kurti stërnipi i Kardinalit i cili organizoj gjithçka për këtë mbrëmje dhe plotësoj dëshirën e babait të tij që ti dhurojë këtë vepër qytetit të Shkodrës.

Falënderim të veçantë për skulptorin Pjerin Kolnikaj të për këtë vepër arti të punuar me mjeshtri e shumë përkushtim.

Po ashtu dhe një falënderim për Maestro Gjon Shllaku me korin e Tij i cili na e zbukuroj këtë mbrëmje duke na ri-sjellur veprat muzikore të Kardinal Mikel Koliqit.

Faleminderit
e Mbrëmje të Këndshme
Imzot Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit
Shkodër-Pult





MBETËT PËRGJITHNJË NË KUJTESËN E NJERËZVE

Kardinal Mikel Koliqi
Shkodër 29.06.2024

*I nderuar Shkëlqësi
Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv
Të nderuar deputetë e autoritete vendore.
E nderuara Familja Koliqi dhe Kurti.
Të nderuar pjesëmarrës në këtë eveniment.*

Hirësia e Tij Mikel Koliqi, është një nga figurat më të ndritura të Kishës katolike shqiptare, njeriu që u bë simbol i gjakut të martirëve, derdhur nga diktatura komuniste në Shqipëri.

Këtë figurë shembullore Kishtarë e Kombëtare po e kujtojmë me fjalët e **imzot Klaudio Maria Çelit**, ish Kryetar i Këshillit Papnor të Komunikimeve Shoqërore, i cili, si përfaqësues i Selisë së Shenjtë, gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri në vitin 1991 e pati njohur e takuar në Shkodër dom Mikel Koliqin. Rasti që një ndër takimet e para që përfaqësuesit e Selisë së Shenjtë takonin popullin dhe klerin e persekutuar, që posa kishin dal nga dimri egër i diktaturës ateiste të komunizmit.

I zgjodha pikërisht fjalët e imzot Klaudio Maria Çelit, për të nënvizuar se figura si ajo e Kardinalit Mikel Koliqi, mbeten përgjithnjë në kujtesën e njerëzve, si simbol i gjakut të derdhur të martirëve, prej diktaturës komuniste në Shqipëri. Ja si e kujtoi Imzot Çeli, në sa përshkruante Meshën e kremtuar në Katedralen e Shkodrës, më 21 mars 1991:

“Sapo e kishim filluar Meshën, kur hyri në Pallatin e Sportit Monsinjon Koliqi. Ishte vikari i përgjithshëm, që kishte shpëtuar gjallë nga persekutimi: fizikisht i shkatërruar, por tmerrësisht i gjallë e i fuqishëm në shpirt.

Hyri, i mbajtur për krahësh nga dy të rinj. Figurë interesante, emocionuese. Madje fjala interesante nuk mjafton për të shprehur atë që ndjemë të gjithë atë çast, sepse ishte një pamje e papërshkrueshme. Më tha: “Unë nuk dal më prej shtëpie, por kur më thanë se ju jeni këtu, e ndjeva



për detyrë të isha i pranishëm, në një çast kaq të pritur, kur përfaqësuesi i Papës asht mes nesh! Fillova homelinë. E kujtoj akoma, sepse më delte nga zemra, pa pasur nevojë fare për përgatitje. E, me që ishte data 21 mars, shqiptova fjalët: “Dimri po shkon! Sot fillon pranvera!”.

E pikërisht sot, Ne festen e Shën Pjetrit dhe Shën Palit, në këtë ditë vere po inaugurojmë këtë monument i cili lë një shenjë në qytetin e Shkodrës. Me këtë monument i kthen Shkodrës birin e Saj që vërtetë i mungonte. E ku tjetër, përveç se në oborret e Katedrales së Shkodrës, vend ku Ai i shërbeu si Famullitar. Faleminderit

Mons. Luigi Bonazzi
Nunci Apostolik në Tiranë





ME NJË DASHURI TË MADHE PËR KRISHTIN

Inaugurimi i bustit të Kardinal Mikel Koliqi Shkodër dt. 29. 06. 2024

*Shkëlqesia juaj, imzot Luigi Bonazzi
Shkëlqesia juaj, imzot Angelo Massafra
Të nderuara autoritete kishtare
Të nderuar deputetë*

Zonja dhe zotërinj

Të jem sot mes jush, në këtë ceremoni, që të flas për kardinal Koliqin në emër të prindërve të mi, të vëllezërve, motrës së kardinalit, është emocion, nder dhe krenari. Por njëkohësisht ndjej edhe përgjegjësi që të çoj përpara amanetin e tim e ti që u nda nga jeta para pak kohësh. Jam i vetëdijshëm sa i lumtur do të ishte po ta përjetonte këtë moment mes nesh. Sa ishte gjallë dhe deri në frymën e fundit bëri çdo gjë për ta përcjellë tek të tjerët madhëstinë që e karakterizonte eminencën e tij. Ai na la një amanet që unë duhet ta çoji përpara tek brezat pasardhës e kështu me radhë.

Isha vetëm 17 vjeç dhe më duket sikur e shoh edhe sot atë pamje kur hyri në shtëpinë tonë, ndërsa në duar mbante dy çanta me rroba të vjetra dhe nga ai moment pata fatin që ky njeri, me shumë durim e me fjalët e tija plot dashuri urtësi dhe dije të më ndihmojë në edukimin dhe pasurimin tim kulturor, e për këtë i jam mirënjohës dhe do jem për gjithë jetën time. Më ka mësuar si të jem i fortë, me integritet dhe i palëkundur përballë padrejtësive.

Me një dashuri të madhe për Krishtin, e po aq edhe për vendin e tij, ai do të kishte fatin e keq si shumë klerikë të vuante mbi supe burgjet e egra të diktaturës komuniste, internimet dhe përndjekjen gjakatare të atij regjimi. As torturat çnjerëzore nuk e dorëzuan, por përkundrazi e bënë më të fortë dhe të palëkundur në besimin e tij. Ai u bë shembull i qëndrues, besnikërisë i parimeve të forta tek të cilat besonte.

Viti 1994 ishte një moment kulmor, për kombin tonë. Ai kishte mbi supe 92 vite jetë, por ati i shenjtë Papa Gjon Pali i dytë, sot shenjt i kishës katolike, i dha titullin e lartë kardinal. Bëhej kështu i pari kardinal shqiptar, duke i dhënë dinjitetin e mohuar për afro 50 vite, kishës shqiptare, që vuajti aq shumë nga ai

regjim i tmerrshëm.

Duke e kujtuar kardinal Mikel Koliqin, nuk ke se si të mos ndjesh edhe keqardhje që pas kaq vitesh, askush nuk kërkoi një ndjesë për titullin që i dha diktatura komuniste duke e quajtur armik të popullit. Është një ndjesë që më shumë se askush e meriton populli shqiptar, që vuajti aq shumë, e pagoi aq shtrenjtë “ çmendurinë” e një regjimi që goditi kombin e vet.

Sot ky përvjetor i 30 i atij momenti kur eminenca e tij u shpall kardinal, e gjen kishën katolike dhe kombin tonë në të tjera rrethana, por kurrë nuk duhet ta harrojmë të shkuarën. Ajo që kaluam le të jetë mësim për brezat, që mos të rrezikojmë të na përsëritet historia.

Në emër të familjes dua të shpreh falënderimet për të gjithë ju që sot jeni të pranishëm dhe të gjithë ata që nuk e harrojnë figurën e dashur të kardinal Koliqit.

Falënderoj në mënyrë të veçantë për mbështetjen Imzot Angelo Massafra, dom Vlash Palaj, mikun e familjes Lorenc Lukën që më ndoqi në këtë nismë dhe padyshim skulptorin Pjerin Kolnikaj që me artin e tij përjetësoi kardinalin tonë, të kthyer sot këtu, në shtëpinë e tij.

Salvator Kurti





Don Lush Gjergji

LUFTA VETËMOHUESE KUNDËR SËMUNDJEVE E VARFËRISË

*45 – vjetori i marrjes së çmimit Nobel për Paqe të Nënës Terezë
(Oslo, 10 dhjetor 1979)
disa kujtime, përjetime, dëshmi dhe porosi!*



Vitet po shkojnë dhe kalojnë shpejt, mos të them po fluturojnë, ndërsa ne po piqemi dhe plakemi pa shmangieje dhe përjashtime. Pra, po iu kthehem kujtimeve, që për ju ndoshta janë edhe zbulime, dëshmi dhe porosi.

Posa mora vesh që Nëna Terezë do ta merrte Çmimin Nobel për Paqe, në vitin 1979, fill shkova në Beograd te ambasada e Norvegjisë, dhe si biograf i saj shpreha dëshirën që së bashku me Imzot Nikë Prelën, ipeshkvin tonë, të merrnin pjesë në këtë ngjarje unike dhe madhore.

Ashtu edhe ndodhi. Ftesa e qeverisë së Norvegjisë erdhe në Ferizaj nëpërmjet Ambasadës së tyre në Beograd.

Zbulimi im i parë publik është konteksti i kësaj ngjarjeje, kur dy kandidatet kryesor për këtë Shpërblim ishin Papa Gjon Pali II (1920-2005) dhe Kryetari i atëhershëm i Jugosllavisë Josip Broz Tito (1892–1980).

Papa i ri polak, i pari si i tillë në histori, në moshën 59 vjeçare, me paraqitje dhe veprime të

jashtëzakonshme, në një mënyrë iu “imponuar” mbarë botës, sidomos të krishterëve, në veçanti katolikëve.

Prandaj pritjet, dëshirat, kërkesat, sytë dhe zemra e mbarë njerëzimit ishte drejtuar kah ky falënderim i Zotit dhe Popullit. Pritej që Papa Gjon Pali II ta merrte Shpërblimin Nobel për Paqe në vitin 1979.

Në anën tjetër, si rival apo kundër – kandidat ishte Kryetari atëhershëm i Jugosllavisë, Josip Broz Tito, si bashkëthemelues i Lëvizjes së të pa inkuadruarëve – themeluar më 1 shtator 1961, me Indinë (Xhevahalat Nehru) dhe Egjiptin (Abdel Nasser), ku e tërë Jugosllavia, me mjete publike, media dhe financa, kishte propozuar dhe përkrahur Titon për Shpërblimin Nobel për Paqe.

Këshilli i Komitetit Nobel për Paqe në krye me Dr. John Sannes kishte kërkuar mendimin dhe vlerësimin e Konferencës Ipeshkvore Jugosllave (KIJ). Vendimi i tyre gati i njëzëshëm ishte ky: Josip Broz Tito ka dënuar, burgosur dhe vrarë me qindra meshtarë, sidomos në Kroaci dhe në Slloveni gjatë viteve 1945 –



1948, kur Jugosllavia u tërhoq prej “Paktit të Varsaves” dhe mori një drejtim të ri.

Prandaj, Josip Broz Tito nuk e mori pëlqimin e Konferencës Ipeshkvore Jugosllave, dhe si i tillë, ishte i “papërshtatshëm”, ndërsa Papa Gjon Pali II, si kreu i Kishës Katolike në botë, nuk ishte i pëlqyeshëm, sidomos në qarqet e masonerisë dhe ndër botëkuptimet e shekullarëve apo laikëve.

Figura e tretë, deri diku “neutrale” ishte Nëna Terezë. Këshilli i Komitetit Nobel për Paqe për një javë për së afërmi në Kalkutë dhe në rrethinë e kishte vëzhguar dhe hulumtuar jetën, sidomos veprën e Nënës Terezë dhe Misionareve të Dashurisë.

Vendimi i tyre tashmë ishte i sigurte, ajo vërtet këtë e meriton ma shumë se askush tjetër.

Dr. John Sannes i tha Nënës Terezë: “Juve iu kemi zgjedhur sivjet për Çmimin Nobel për Paqe.”

Nëna Terezë, ndoshta edhe e befasuar nga ky lajm, sidomos e lodhur dhe e mërzhitur prej shumë shpërblimeve, tha: “Është një vështirësi e vogël... Më jepni së paku pak kohë që të mendoj dhe të lutem.”

Ashtu edhe ndodhi. Nëna Terezë personalisht ishte këshilluar me Papën Gjon Pali II, Ajo ndër të tjera i kishte thënë kështu: “Shenjtëri, jam e lodhur dhe e mërzhitur nga gjitha këto shpërblime... Shpërblimi im i vetëm është Jezusi dhe të varfëritë...”

Papa Gjon Pali II e kishte dëgjuar me vëmendje dhe i kishte thënë: “Nëna Terezë, pranojeni këtë Shpërblim në emër të Zotit, Kishës dhe të varfërve!”

Aty për aty ajo e kishte pranuar këshillin dhe dëshirën e Papës, pasi që “Fjala e Papës është vullnesa e Zotit!” Ndër të parët që ia kishin uruar Nënës Terezë Shpërblimin Nobel për Paqe ishte Presidenti i atëhershëm i Jugosllavisë, Josip Broz Tito, i cili ndër të tjera shkruante kështu:

“Ju uroj për zemërsisht mirënjohjen e lartë – “Çmimin Nobel për Paqe”. Aktiviteti i Juaj fisnik shumëvjeçar dhe lufta vetëmohuese kundër sëmundjeve e varfërisë gëzon kësodore mirënjohjen e merituar, e cila besoj se do të jetë impuls për angazhim më të gjerë për të mirën e njeriut.”

Me 8 dhjetor 1979 Imzot Nikë Prela dhe unë e pritëm te shkallët e aeroplanit në Oslo. Fjala e parë e Nënës Tereze ishte kjo: “Jam këtu në emër të Zotit, Kishës dhe të varfërve për ta pranuar Shpërblimin Nobel për Paqe!”

Gjatë atyre ditëve Nëna Terezë kurrë nuk kishte thënë asnjë herë: Çmimi Nobel për Paqe i imi, por i të varfërve, me bindje se tash e tutje bota do t'i njehte dhe ndihmonte të varfëritë, si dhe paqja në botë do të vijë nëpërmjet të tyre.

Në këtë stil ajo kishte refuzuar drekën apo darkën pas marrjes së Shpërblimit Nobel, duke i ndarë ato mjete financiare me të “varfër ndër më të varfër.”

Teza bazë që e kishte shtruar Nëna Terezë gjatë fjalimit në Katedra e Paqes ishte kjo:

– Identifikimi i tyre me Jezusin, pasi që ata janë vëllezër dhe motra tona;

– Detyra që të pasurit t'i ndihmojnë në varfrit, sepse vetëm ashtu do të jenë të lumtur.

– “Veprat e dashurisë janë vepra të paqes”, që me fjalë tjera paqja nuk është fryt i marrëveshjeve të krerëve shtetërorë, i ushtrive apo policive, por më tepër çështje mendjeje dhe zemre, pasi që: “Pa dashuri dhe flijim jeta nuk ka kuptim” dhe “Vetëm Dashuria do ta shpëtojë botën.”

Në përcjellje të Nënës Terezë në aeroportin e Oslos ishte edhe Dr. John Sannes, Kryetari i Komitetit Nobel për Paqe. Ai ndër të tjera i tha Nënës Terezë kështu:

“Ju na keni nderuar më shumë neve, se ne Juve, meqë e keni pranuar Shpërblimin tonë. Kjo dukshëm ia rritë çmimin dhe vlerën Çmimit Nobel për Paqe, pasi që mbarë bota na ka përgëzuar dhe uruar: Së fundi ky Shpërblim ka ardhur në duar të sakta dhe të vërteta... Për këtë për zemërsisht Ju falënderojmë...” Pastaj si në hoka, por edhe me bindje, tha edhe këtë: “Tash pas këtij Shpërblimi keni krijuar edhe një hall apo vështirësi për ne, pasi nuk kemi ndonjë personalitet si Ju. Prandaj duhet të na ndihmoni dhe këshilloni për të ardhmen...”

Pas pak pushimi dhe qeshje, ai ndër të tjera tha: “Më së miri do të ishte që Juve t'ua japim Çmimin Nobel për Paqe deri sa të jeni gjallë!”

Nëna Terezë na tha se do ta vizonte në Romë Papën Gjon Pali II dhe do të jepte dorëheqja nga detyra e Eprores Gjenerale të Misionareve të Dashurisë. Në përcjellje ishte vëllai i saj, i ndjerë Lazër Bojaxhiu, mbesa e ndjerë Age lind. Bojaxhiu – Guttadauro dhe disa motra të rendit të saj.

Papa Gjon Pali II edhe një herë ia uroj dhe e përgëzoi për Shpërblimin më të lartë dhe më të njohur në botë.

Nëna Terezë, pasi e përcolli me vëmendje çdo fjalë të Papës, ndër të tjera tha: “Shenjtëri, unë kam vendosur që të jap dorëheqje nga vendi i Eprores Gjenerale të Misionareve të Dashurisë dhe t'i kthehem jetës së vetmisë, uratës, meditimit, adhurimit... në “Qytetin e Haresë”, në mesin e të gërbulurve...”

Papa Gjon Pali II edhe një herë e kundërshtoi me këto fjalë: “Kurrësesi, pasi Ti je Dëshmitarja më bindëse e Krishtit dhe e Kishës Katolike. Prandaj, të lutem në Emër tim dhe të Kishës: Shko dhe dëshmo Krishtin dhe dashurinë e tij kudo që të thërrasin!...”

Edhe një herë Nëna Terezë e ndërroi vendimin dhe u “dorëzua” para kërkesës së Papës, nëpërmjet tij, kuptohet, Zotit.

Ja, pra, e tillë ishte Shën Nëna jonë Terezë.

Prishtinë, 26 gusht 2024



ITINERARE KATEKUMENTALE PËR JETËN MARTEORE

Këto rreshta nuk pretendojnë të jenë shteruese dhe i referohen leximit të dokumentit të hartuar nga Dikasteri për Laikët, Familjen dhe Jetën. Synimi që ata i vendosin vetes është që t'i ndihmojnë reflektimit dhe t'i hapen "së bashku" Shpirtin që gjallëron tekstin: vetëm një ndërgjegjësim i gjithëmbarshtëm do të jetë në gjendje ta bëjë të frytshëm angazhimin e përbashkët, në zbatimin e asaj që i kërkohet të gjitha bashkësive, famullive dhe mbarë Dioqezës.

Fjala "Itinerar" do të thotë "rrugë" dhe nuk ngjall vetëm synime individuale për t'u arritur, por vazhdimësi udhëtimit, drejt një destinacioni të zgjedhur që në fillim; për këtë arsye dokumenti i referohet Pagëzimit dhe Katekumenatit; Pagëzimi kujton realitetin e gëzueshëm të të qenurit "Bij të Zotit", fëmijë të Dashurisë (nxitja Apostolike e Papa Franceskut në Amoris Laetitia), katekumenati bën thirrje për një mënyrë të pranisë së bashkësisë kishtare që "mund të frymëzojë shtigje të reja të rinovimit të besimit në çdo epokë". Rruga katekumenale e nisur me Pagëzimin mund të vazhdojë ashtu, si prindërit kujdesen për jetën e trupit, i gjithë komuniteti kishtar, i cili kujdeset për jetën e shpirtit, nëpërmjet katekzës specifike sakramentale dhe përmes dëshmisë së jetës, duhet të shoqërojë fëmijët dhe adoleshentët, derisa ta kuptojnë se; të jesh i krishterë do të thotë të jetosh "Krishtin i gjallë", Biri e Hyjit të bërë njeri. Ndërsa trupi piqet dhe rritet, për shkak të forcës së brendshme të jetës, maturimi si njerëz kërkon që bashkësia kishtare të jetë e pranishme dhe të ndërveprojë me të rinjtë, në unitetin e tyre të papërsëritshëm, sepse:

- 1) mund të kuptojë komponentët e ndryshëm që strukturojnë personalitetin e tyre,
- 2) janë në gjendje t'i harmonizojnë ato me njëri-tjetrin,
- 3) zgjedhin si dhe me kë të vazhdoni rrugën e jetës,
- 4) të njohin se çfarë lloj prindërimi i bën ata të ndihen të përmbushur,
- 5) zbulojnë se si dhe me kë të planifikojnë të ardhmen për t'u dhënë jetë "Bijve të Zotit" të rinj,
- 6) mund të verifikojnë vlefshmërinë e zgjedhjes së tyre për të ndërtuar dhe ruajtur atë klimë dashurie që favorizon jetën fizike dhe shpirtërore të fëmijëve të tyre.

Rruga është e njëjtë për të gjitha zgjedhjet e mundshme të jetës së krishterë; jetike dhe e shëndetshme është se nuk ka ndërprerje apo përjashtim të ndonjë dimensionit thelbësor antropologjik. Katekumenati bashkëshortor vendoset në këtë rrugë



unike; ai fokusohet në pikat 5 dhe 6, por duhet të ketë parasysh të gjithë rrugën e rritjes njerëzore dhe shpirtërore të individëve dhe të çiftit, për të kompensuar mangësitë historike ose individuale që mund të rrezikojnë arritjen e qëllimit të caktuar. Është një veshje që duhet të jetë "i prerë" për personat që do ta veshin.

Zhvillimi i një itinerari të llojit katekumenal të përgatitjes për martesë dhe shoqërimi konkret i çifteve në këtë rrugë janë një detyrë që i takon të gjithë bashkësisë kishtare, në një rrugëtim të përbashkët mes priftërinjve, bashkëshortëve të krishterë, bashkëpunëtorëve baritorë, të cilët duhet të bashkëpunojnë mes tyre dhe në dialog të vazhdueshëm me Ipeshkvin.

Martesa nuk është vetëm një fakt shoqëror, por për të krishterët është një realitet që i përket "Krishtit". Prandaj, dëshmia jetësore e bashkëshortëve të krishterë, trajnimet dhe takimet: me të rinj, çifte të fejuara dhe bashkëshortë të rinj, duhet të jenë totalisht të orientuara drejt "gjallërimit të pranisë së Krishtit"; Zoti Dashuri i mishëruar, domethënë i bërë mish e gjak. Biri i Hyjit jo vetëm që jeton në thellësitë e çdo të krishterë: "Mbretëria e Hyjit është brenda jush" (Lk. 17,21), por, nëpërmjet hirit të martesës, takon dhe kërkon të njihet përballë bashkëshorti; Ai është në secilën prej tyre dhe gjithashtu "me ta dhe mes tyre".

Në dokument thuhet gjithashtu se: "Bashkësitë kishtare të ndryshme do të duhet të zhvillojnë propozime më praktike dhe efektive, të cilat marrin parasysh si mësimet e Kishës ashtu edhe nevojat dhe sfidat lokale". Dioqeza e Shkodrës tashmë ka ndërmarrë projektin e saj pilot; do të duhet të përmirësohet dhe të zbatohet, por jemi të sigurt se ardhja e Ipeshkvit të ri në mesin tonë do të jetë një nxitje dhe udhërrëfyes për laikët, meshtarët dhe besimtarët për të kapërcyer çdo sfidë dhe çdo vështirësi.

Mt. Rita Ndoci



MISTER TË MADH PËRMBAN SAKRAMENTI I MARTESËS!

Përgatitja e çifteve të reja për martesë



Më 11 shtator të vitit 2023, në Asamblenë e përvitshme dioqezane të Arqidioqezës Shkodër-Pult, u paraqit dhe u diskutua, tashmë i përkthyer, dokumenti “Itinerare katekumenale për jetën martesor”; dokumenti i publikuar nga Dikasteri i Vatikanit për Laikët, Familjen, dhe Jetën. Në këtë dokument, ndër të tjera, paraqitet nevoja që të bëhet një përgatitje më e gjatë dhe e strukturuar e çifteve të reja që përgatiten për Sakramentin e Kunorës së shenjtë. Gjatë Asamblesë dioqezane dhe pastaj në Këshillin Presbiteral u diskutua mbi propozimet që bëheshin brenda dokumentit. Në fillim të dhjetorit të 2023 Arqipeshkëvia dërgoi një letër ku paraqiteshin disa vendime të Këshillit Presbiteral e, ndër të tjera, paraqitej vendimi që të ndryshojë forma dhe zgjatja e përgatitjes së Martesës sakramentale.

Vendimi kërkonte që të bëheshin 12 takime përgatitore për martesë dhe këto takime duhej të drejtoheshin nga persona dhe figura të ndryshëm. Parashikoheshin dy takime me famullitarin, një takim me një person të jetës së kushtuar, një takim me një çift me disa vite martesë, dy takime me mjekun, një takim me psikologun, një takim me avokatin dhe një takim me një çift katekist. Këto norma duhej të futeshin në fuqi më 7 Janar të këtij viti.

Në famullinë e “Naltimit Krygjes” në Stajkë,

duke ndjekur udhëzimet dhe vendimin e sipërpërmendur, që në dhjetor të vitit të kaluar, janë lajmëruar të gjithë ata që dëshironin të kremtonin Sakramentin e Kunorës në vitin 2024. Pasi është bërë një takim individual me famullitarin për verifikimin e dokumentave dhe paraqitjen e ecjes përgatitore, janë organizuar takimet e përbashkëta të cilat kanë qenë *on-line* pasi shumica e tyre nuk jetojnë në Shqipëri. Me kalimin e muajve janë zhvilluar takimet siç parashikohen në vendimin e Këshillit Presbiteral. Çdo takim, duke respektuar natyrën e fushës së vet, kishte si qëllim vetëdijesim mbi dhuratën e Misterit të madh që përmbahet në Sakramentin e Martesës. Të gjithëve u është dhënë mundësia të ndërhyjnë nëse kishin paqartësi dhe gjithashtu u jepej mundësia e bisedave personale thelluese pas takimeve. Takimi i fundit me famullitarin, që paraprin kremtimin e Sakramentit, është bërë (ose do bëhet) sërish personal.

Çiftet e reja, nga sa ata vetë referojnë, kanë mbetur shumë të kënaqur nga kjo ofertë formuese dhe nga fakti që takimet, duke qenë se nuk ishin intensive por të shtrira në kohë, jo vetëm që nuk i kanë lodhur por u ka dhënë mundësinë e shoshitjes dhe shijimit më të thellë të Misterit sakramentor para të cilit janë gjetur.

Dom Jetmir Nikolli, Famullitar, Stajkë



NUK MUND TË MOS GËZOHEMI E TË FALËNDEROJMË ZOTIN

Prot. N. 90/2024
Shkodër, 27/07/2024

Lënda: data e lumturimit në Shkodër: 16 nëntor 2024

Të dashur vëllezër e motra në Krishtin,

Zoti ju dhashtë paqen!

Me kënaqësi të madhe po bashkëndaj me secilin prej jush gëzimin e lajmit të shumë pritur për të gjithë: datën e Lumturimit të dy Martirëve tanë të rinj, të cilët dhanë jetën për fe e atdhe, atë Luigj Palić (Paliq) e dom Gjon Gazulli.

Sekretaria e Shtetit të Vatikanit ka vendosur që kremtimi solemn të zhvillohet në Shkodër më 16 nëntor 2024, të cilin do ta udhëheqë Eminenza e Tij Kard. Marcello Semeraro, Prefekt i Dikasterit për Çështjen e Shenjtërve.

Nuk mund të mos gëzohemi e të falënderojmë Zotin e Atin e Shenjtë Papa Françeskun për këtë dhuratë. Por sikurse çdo dhuratë, edhe kjo kërkon një përgjegjësi të konsiderueshme.

Përsa i përket organizimit të nevojshëm që ngjarja të shkojë sa më mirë, Postulatori i Çështjes, Atë Gianni Califano OFM, të cilin e falënderoj, e ne Ipeshkvijtë e Konferencës Ipeshkvore jemi duke punuar prej kohësh. Ndërsa juve, të dashur meshtarë, rregulltarë-rregulltare e juve, të dashur vëllezër e motra, ju kërkoj një angazhim bujar lutjeje që ky lumturim të mund të japë për Kishën në Shqipëri e Kosovë fryte shenjtërie e thirrje të shenjta në meshtarinë ministeriale e në jetën e kushtuar.

Ju kërkoj që në çdo bashkësi të shtohet një nijet lutjeje gjatë kremtimit të çdo meshe të së dielës (*duke filluar nga muaji gusht*) e në fund të recitimit të Rruzares së shenjtë.

Bekimi im ardhhtë mbi ju të gjithë!

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult

SHËNIM: Shpallja e lumturimit të lexohet në të gjitha meshat e së dielës, me 4 gusht 2024.



Atë Luigj Palić (Paliq)



Dom Gjon Gazulli



PËRVOJË NË GJURMËT E MARTIRËVE

Nga data 19 deri me datën 22 gusht 2024, një grup prej 25 adoleshentësh italianë nga famullia “Beata Vergine Maria Adolorata” (“E Lumja Zoja e Dhimbshme”) e Tavianos në provincën e Leçes (Itali), bënë një shtegtim në gjurmët e Martirëve të Lumë të Shqipërisë së shekullit XX.

Të shoqëruar nga famullitari i tyre, Dom Graziano Greco, si dhe nga animatorët e tyre, njëra prej të cilave është nënkryetarja e Bashkisë së Tavianos, ata iu besuan drejtimit të Atë Luigi Aluisi-t O.F.M., i cili i shoqëroi në këtë rrugëtim, duke përshtatur përmbajtjen shpirtërore dhe historike të këtij shtegtimi me moshën e të rinjve pjesëmarrës.

Ndalesat ishin: Muzeu dioqezan, që kontekstualizoi praninë e tyre në Shqipëri dhe i njohu me Martirët; Memoriali i Martirëve me dëshminë e motrave Klarise të Shkodrës; vizita në vendet ku ruhen eshtrat e Martirëve: Stigmatine, Gjuhadol, Katedrale e Shkodrës dhe Konkatedrale

e Durrësit. Fatkeqësisht, mungesa e kohës nuk mundësoi vizitën në Dajç të Bregut të Bunës, në Blinisht dhe në Lezhë.

Dy takime iu rezervuan edhe vizitës në dy struktura që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara: “Madonnina del Grappa” në Razëm dhe “Projekti Shpresa” në Shkodër.

Arqipeshkvi Imzot Massafra iu bashkua shpesh grupit, duke i takuar anëtarët e tij, duke sjellë dëshminë e tij misionare dhe duke bashkëndarë disa momente me ta, si për shembull një shëtitje të shkurtër me varkë në liqenin e Shkodrës.

Grupi ndoqi me kujdes dhe përvetësoi çdo moment. Ata u kthyen në Itali me shpresën që, pasi të arrinin moshën madhore, disa prej tyre të kthehen dhe të ofrojnë kontributin e tyre për Kishën tonë në forma të ndryshme.

Imzot Angelo Massafra
Arqipeshkev





PLANIFIKONTE NJË UDHËTIM TË MIQTË E TIJ TË VJETËR!

Më 29 qershor 2024 ka kaluar në amshim Dom Fabio Cassol-i.

Ishte 85 vjeç, prej të cilëve 59 meshtari. Vdekja e papritur ndodhi në përvjetorin e tij të shugurimit.

Homelia e Ipeshkvit, Renato gjatë funeralit

Me pikëllim të thellë, njoftojmë vdekjen e Dom Fabio Cassol-it, në moshën 85-vjeçare. Të premtën doli nga seminari, ku banonte, për të bërë një shëtitje në freskinë e mbrëmjes. U gjet i vdekur jo larg makinës së tij.

Lindi në Shën Gregorio në Alpe, më 30 nëntor 1938, nga martesë e Guglielmo dhe Margherita Paganin-it, të cilët i vunë dy emra: Fabio Karlo. Pasi hyri në seminarin dioqezan, përfundoi ecjen formative dhe u shugurua meshtar më 28 qershor 1965, saktësisht 59 vjet më parë.

Hapat e parë në mbarështim i bëri si vikar bashkëpunëtor në Kadola (1965-1967), në Santo Stefano të Kadores (1967-1968) dhe në Kastion (1968-1969). Më pas, duke pasuar Dom Rinaldo Andrich-in, qe famullitari i dytë i Levego-

Sagronjës, bashkësi që udhëhoqi nga viti 1969 deri në vitin 1985. Më pas u transferua në famullinë e afërt të Vizomes nga viti 1985 deri në vitin 1993. Dhe nga viti 1993 deri në vitin 1997 qe famullitar i Pezit.

Krahas mbarështimit si famullitar, në vitin 1969 mori një detyrë apostolike në emër të Komisionit dioqezan "Migrantes", duke ndjekur nga ana baritore punëtorët e cirkut dhe të lojërës për fëmijë; nga viti 1989 deri në vitin 1992 qe zëvendës-asistent i Lëvizjes Punëtore; nga viti 1990 qe kryetar i komisionit "Justitia et pax". Nëse këto detyra tregojnë diçka mbi të qenit e tij "prift kufiri", nuk të befason aspak zgjedhja që në vitin 1998 e çoi atë që të bënte një përvojë misionare në Shqipëri: dy fotot më poshtë i referohen kësaj faze të jetës së tij, ku e shohim duke kremtuar një pagëzim në natyrë dhe ndërsa udhëton mbi kurrizin e një gomari. Mbeti i lidhur me këtë tokë, ku po planifikonte të bënte, së shpejti, një udhëtim për të takuar miqtë e tij të vjetër.

Pas kthimit në Itali, nga viti 2001 deri në vitin 2008 ishte famullitar në Voltago, Frasene dhe Gosaldo; në vitin 2008 u bë famullitar i Rasait, ku qëndroi deri në vitin 2018. Kaloi një periudhë në Fortonja, për të ndihmuar famullitarin e bashkësive të Longaronezes. Kohët e fundit, u tërhoq në Seminarin e Belunos, duke vazhduar të ndihmonte për kremtimet në dioqezë. Në vitin 2023 u caktua si ndihmës kishtar i Lëvizjes Apostolike të Verbërve.

Funerali u zhvillua në Katedrale, të martën më 2 korrik, në orën 15.00; trupi u varros në varrezat e Shën Gregorit në Alpe. Në kishën e famullisë së Shën Gregorit, të hënën 1 korrik, në orën 20.00, u zhvillua Rruzarja në kujtim të Dom Fabios.

Ipeshkvi Renato, Ipeshkvi Emerit Giuseppe (shok shugurimi), krejt presbiteri dhe diakonët e dioqezës bashkohen në lutje, të cilën ia ofrojnë Zotit për shpirtin e këtij prifti të zellshëm dhe të apasionuar. Në të njëjtën kohë ata u dërgojnë familjarëve ngushëllimet e tyre.





TEMA PËR FAMILJE NË SHOQËRINË TONË SHQIPTARE *Kampi veror 2024 në famullin e Shkrelit Malësia e Madhe*

Në vazhdimësinë e aktiviteteve edhe në famullin e Shën Kollit në Shkrel, Malësia e Madhe në muaj gusht u organizua kampi veror nën kujdesin e famullitarit dom Nikolin Toma në bashkëpunim me Jezuitet e Kishës së Universitetit Shtetëror të Maltës si dhe me shoqatën Vis Albania.

Tema e sivjetme e kampit veror ishte “Familja m'groh” ku gjatë aktiviteteve tre javore u zhvilluan tema të ndryshme mbi rendësin e familjes në shoqërinë tonë shqiptare.

Gjatë kampit veror për të gjithë pjesëmarrësit u organizuan shëtitje në vendet historike dhe kulturore për tu njohur më mirë me të shkuarën e vendit tonë. Një ndër mbresat e veçante që la gjurmë ishte vizita në Muzeun e Kujtesës dhe në Muzeun dioqezan në Shkodër.

Pjesëmarrja ishte shumë e kënaqshme ku morën pjesë rreth 80 fëmijë dhe të rinj nga famullia e Shkrelit. E veçanta e këtij kampi ishte se po zhvillohej për të dhjetën herë pa shkëputje dhe kjo ngjarje e krijoj klimën e një familje që dinë të ecë dhe të festojnë së bashku.

Gjatë kampit veror patëm kënaqësinë të na



vizitonin edhe ipeshkvijtë tanë Mons Angelo Massafra dhe Mons Giovanni Peragine ku u informuan mbi veprimtarin e kampit dhe mbi jetën e përditshme të famullisë së Shkrelit.

Në përfundim të kampit veror u hodhën ide të ndryshme që të ngjallet shpresa, ku shpirti krijues të bëhet frymëzim i ecjes tonë si bashkësi famullitare dhe dioqezane.

Kronisti

KEMI MEDITUAR FJALËN E ZOTIT *Përvoja e seminaristeve me ipeshkvin në Razëm Dt. 5-8 korrik 2024*

Prej vitesh dioqeza e Shkodrës e ka pasur traditë që ipeshkvi me ftuar seminaristet e dioqezës për të bërë një përvojë dhe me ju ofruar një moment njohje në fshatin e bukur turistik sikurse është Razma në shtypin e pushimeve të Ipeshkvit. Por për shkak të numrit të vogël në këto vitet e fundit u ndërpre kjo mundësi dhe përvojë. Në këtë vit duhet për të falënderuar Zotin që në dioqezën tonë janë dy djem të rinj Kristian Gjoni dhe Joel Jaku që kanë përfunduar vitin e propedeutikut dhe disa të tjerë që janë duke shqyrtuar thirrjen për të hyre në Seminar, falë këtij numri të mirë është rimarr kjo traditë e vjetër.

Kështu e përshkruan përvojën e vet tre ditore njëri prej djemve.

“Eksperiencia në Razëm me Mons. Angelon dhe me seminaristet e tjerë të dioqezës ka qenë mjaft e veçantë. Kemi përjetuar një kohe meditimi dhe reflektimi, mbi vetveten duke marrë parasysh rrugën që do të marr në Seminar. Kemi pasur momente lutjeje dhe takime formimi por ajo që ishte më e rëndësishme ishin takimet personale me ipeshkvin. Kemi medituar fjalën e Zotit duke u ndalur veçanërisht tek shëmbëlltyrat që Jezusi iu ka treguar njerëzve. Ajo që me ka bërë më shumë përshtypje ishte vizita tek një

çift të moshuarish të cilët jetonin në kushte të vështira ekonomike dhe me djalin e tyre të sëmure. Në atë moment u ndjeva shumë i mërziur por në të njëjtën kohë i gëzuar për ato njerëz që nuk e ndalojnë kurrë besimin dhe shpresën në Zotin edhe pse jetojnë në vuajtje. Në shpesh krijojme kontradikta duke mos e falënderuar Zotin për të mirat që na ka dhënë. Në jemi gjithmonë borxhli ndaj Atij që na jep gjithçka, te gjithë duhet të marrim shembullin e kësaj familjeje”. Këto janë përvoja që na ndihmojnë për tu rritur njerëzisht për të kuptuar më mirë vështërsit dhe mundimet që kanë shumë njerëz në këtë botë.

Ajo që ka vlerë dhe rëndësi të madhe është të qënurit mirënjohës gjithë atyre që e kanë mundësuar në forma të ndryshme përvojën e Ipeshkvit me seminaristet e vet në Razëm, Zoti jua shpërbleftë me të mirat dhe bekimet e veta. Falënderojmë shumë edhe Atë Luigjin i cili është përkushtuar në kuzhinë dhe në animimin e Liturgjisë. Mbi të gjitha falënderojmë te gjithë ato besimtar të vendit që kanë marrë pjesë në Meshën Shenjte dhe për mirësinë që kanë treguar ndaj nesh gjatë këtyre ditëve.

Nikolas Xhakaj



ARBËRORËT TË VENDOSUR NË MES TË DY KULTURAVE!

Në Obiliq-Kastriot, Kosovë, u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: “Lufta e Dytë e Kosovës (1448)”

Më dt/ 20. gusht, 2024, në Obiliq-Kastriot u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: “Lufta e Dytë e Kosovës (1448)”, organizuar nga Komuna e Obiliqit-Kastriotit, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Në konferencë morën pjesë 19 studiues nga Kosova dhe nga jashtë saj.

Qëllimi i kësaj konference ishte të sillen prurje dhe interpretime të reja rreth Luftës së dytë të Kosovës dhe realizimi i idesë për ngritje e një obelisku madhështor në komunën e Obiliqit për ngjarjen në fjalë, Gjergj Kastriotin e Janosh Huniadin.

Fjala e përshëndetëse, u mbajt nga Lulëzim Lajçi, drejtor i Institutit Albanologjik. Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit – Kastriotit; Skender Asani, drejtori i Institutit pre Trashigimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe studiuesi, Dom Nikë Ukgjini.

Fjala përshëndetëse: dom Nikë Ukgjini

Të nderuara autoritete lokale, të nderuar studiues dhe ju pjesëmarrës!

Kam kënaqësi që fillim të kësaj Konference, të rëndësishëm, të ju drejtohem me disa fjalë mendje dhe zemre.

Mendja ma thotë se organizimi i kësaj konference të zgjeruar studimore është një domosdoshmëri, nevojë, për ta rikujtuar, plotësuar dhe ri interpretuar më mirë e më saktë, këtë betejë të historisë sonë, e cila pothuajse, ishte në rrezik mykjeje në sirtarët e arkivave më të rëndësishme evropiane, si dhe në mendjen të disave të brezave të rij. Zemra ma do, sepse sa më tepër që të dëgjojmë e lexojmë, për këto ngjarjeve, aq më tepër në neve zgjohen ndjenjat të trashëgimisë së brezave arbërorë dje dhe sot. Beteja e parë e Kosovës e vitit 1389, ka mbetur nga historiografia e sotme ende si një foshnje

jetime dhe si ngjarje historike e mjegulluar, në krahasim më Betejën e dytë të Kosovës e vitit 1448, e cila sipas burimeve historike konsiderohet si betejë shumë e njohur e ndodhur diku për rreth e qark qytetit ku jemi bashkuar.

Fushë Kastrioti (Obiliq) më 16-19 tetor 1448, ishte bërë fushë mejdan midis aleancës të një pjesë të Evropës papnore të udhëhequr nga Janosh Huniadi dhe ushtrisë osmane në krye me sulltan Muratin II,, e ku Arbrit më në krye me Skënderbeun që ndodheshin në anën e aleancës evropiane, gjatë udhëtimit për në këtë pjesë fushore, “*qenë penguar, si dhe shumë herë të tjera nga mbreti serb, i Shën Savës, Gjuraq Brankoviq, i cili nuk lejoi të kalonte nëpër zotërimet e tij*”, thekson, në kroniken e tij, viti 1893, Jezuiti polak, Marcin Czerminski,

Sidoqoftë nga mesi i shek. XV, Kosova kishte tërhequr vëmendjen e aspiruesve të luftërave kundër





osmanë në krye me, Janosh Huniadin dhe Gjergj Kastriotin. Kosova në betejën e dytë, thekson dom Ndoc Nikaj, në librin e tij, *Historija e Shqypris*, botuar në Bruksel në vitin 1902,” fq. 191, ishte bërë një lufte arene e përgjakshme, në mes ushtrisë e Sulltan Muratit e asaj të krishterë në krye me Huniadin, ku nga të dyja palët patën humbje të mëdha në jetë njerëzish. Territori i Kosovës që në dokumentet e kohës, të Imz., Andre Bogdanit, thirrej Dardani, shihet qartë së në kuptimin gjeografik, ishte pikë-ndeshja kryesore e forcave të mëdha luftarake të ndodhura në mes të Perandorisë Osmane dhe forcave të mëdha katolike të një pjesë të Evropës. Në këtë rast, në mesin e aleancës, forcat e mëdha arbërore patën një rol të jashtëzakonshëm për pengimin e depërtimit të pushtuesve osman, nga ky krah për në Evropën papate.

Figura më emblematike e shek. XV, në Ballkan, por edhe në Evropë, padyshim është ajo e Gjergj Kastriotit, të cilin pararendësit tanë e mbuluan me lavdërime më tepër se çdo hero tjetër të asaj epoke. Ai më zgjuarsinë e guximin përmes luftës 25 vjeçare kundër turqve, bëri që heroizmi arbërorë për herë të parë të jetë i njohur në tërë Evropën.

Albanologu më i shquara i shek. XX, Giuseppe Valentini në studimet e tij, për Gjergj Kastriotin duke i shprehur admirimin thotë: *“Edhe mos të kishte qenë Skënderbeu ngadhënjyes në njih seri luftimesh, të vishtira, por gjithmonë i thyem, në 25 vjet qëndrese kundra Turqve, prape se prape admirimi i em e i çdo Evropiani të ndritur, do i'shte ai qi asht”...* *“prandaj, jeta e vepra e tij, vazhdoi të jetojë edhe me pas, në historinë e letërsinë shqiptare dhe evropiane”.*

Më virtytet të larta njerëzore e ushtarake, Skënderbeu,- sipas Valentinit,- është heroi që bashkoi perëndimin nëpërmjet Papatit si

emërues përbashkimit për tërë mbretëritë Evropiane, qoftë për ato shtete ballkanike që i takonin Kishës Lindore si: Greqia, Bullgaria e Serbia. Me të drejtë papët e Kuries Romake e shpallën “Athleta Christi” e “Defensor fidei”, duke e ngritur Skënderbeun në pedestal 6 shekuj më parë, e shumë më pas, më 18 janar të vitit 1968, Papa Pali i VI-të, e shpalli Skënderbeun si modelin që duhej ndërtuar Evropa e viteve 60-të.

Duke u kufizuar vetëm në botime librash që flasin kryesisht mbi Skënderbeun nga viti 1500-1900. *“Janë rreth 100 të tilla, 10 në shqip, 10 në latinisht e të tjerat në gjuhë të ndryshme evropiane”*, - do shprehej Valentini.

G. Valentinit me anën e *“Aktet Shqiptare –Venedikase”* të botuara në 25 vëllime në gjuhën latine, për periudhën e historisë para dhe të kohës së Skënderbeut, me kritere të rrepta shkencore, u ofron studiuesve një histori të imët, dokumentacion shterues e të mjaftueshëm, për ndërtimin e realitetit të betejave, kur veproi Skënderbeu. Por, mbi Betejën e dytë të Kosovës dhe në përgjithësi për luftën Osmano – Arbërore., padyshim që janë të rëndësishme edhe kronikat – dokumentet , osmane, ato arabe, bizantine, sllave, e ato të tjera perëndimore. Me këto raste është e natyrshme të këtë edhe kundërthënie mes vete për ngjarjet e të se kaluarës. Për këtë arsye, një rrugëdalje e zgjuar është mbajtja e konferencave studimore të kohëpaskohshme të niveleve të ndryshme, kombëtare e ndërkombëtare, që e vërteta të behët mjet çlirimi shpirtërore e moral, për të gjithë. Arbërorët të vendosur në mes të dy kulturave, të Orientit dhe Perëndimit, kanë një mundësi pasurimi kulturor të dyfishtë. Por, njëherësh rrezikon të kanoset në transformimin e një kulture të tipit turko - mysliman dhe të ndërthehet në prangat e vjetra të tipit bizantin, gjë që do të sillte zbrazëtinë dhe thyerjen e saj, veçanërisht në shekujt e fundit.

Andaj Konferencës i dëshiroj suksese.

Marrë nga gazeta:
Dielli - New York.
dt. 23. Gusht 2024





Dr. Paulin Marku

ABAT PREND DOÇI, KLERIKU, ATDHETARI DHE INTELEKTUALI SHQIPTAR

Prend Doçi është një personalitet i rëndësishëm i klerit katolik shqiptar dhe me kontribute të shumta në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte një atdhetar i madh dhe u aktivizua për mbrojtjen e territoreve shqiptare, për zhvillimin e gjuhës, kulturës e traditës sonë kombëtare. Ai lindi më 7 shkurt 1846 dhe u nda nga jeta më 22 shkurt 1917. Prend Doçi e hasim në dorëshkrime e dokumente shqipe dhe të huaja të kohës, si Dom Prend Doçi, Abat Prend Doçi, si dhe emri i tij gjendet edhe në forma të tjera si: Preng Doçi, Prengë Doçi si dhe Prenk Doçi sipas shqiptimit dialektor e krahinor si dhe, sipas dorëshkrimeve të bashkëkohësve të tij. Prend Doçi në shkrimet e tij në gjuhën shqipe e ka shkruar Prend, ndërsa në gjuhën italiane e në latinisht e gjejmë, Primo Dochi, Primus Docci, Primo Docci, dhe prej vitit 1888 pasi u dekretua nga Vatikani, Papa Leoni XIII do të emëronte Dom Prend Doçin “Supra, montem Mirditarum” abatis nullius, i cili do të drejtonte Abacinë e Oroshit të Mirditës dhe do të kishte varësi të drejt për drejtë nga Selia e Shenjte në Vatikan.

Ai lindi në Bulger të Mirditës, më 7 shkurt 1846 dhe pati veprimtari të gjerë klerikale katolike me funksione të ndryshme në Shqipëri, Itali, Mali i Zi, Greqi, Indi, Kanada... Ai ishte diplomat e vizionar me ndjenja të thella atdhetarie, poet, publicist, themelues i shoqërisë “Bashkimi”, shoqëri kjo, e cila, bëri shumë punë të mëdha bashkë me Atë Gjergj Fishtën e Dom Ndoc Nikën e shumë intelektualë brenda e jashtë vendit. Shoqëria “Bashkimi” ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për arsimin shqiptar, nga aty u realizuan shumë botime të karakterit gjuhësor, letrar, historik e kulturor si dhe ishte një zë i fuqishëm për jetësimin dhe mbrojtjen e alfabetit shqip me germa latine dhe për zhvillimin e shkollës shqipe. Abat Doçi ishte kontribues i madh për zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe drejtues i rëndësishëm i kishës katolike në krahinën e Mirditës, në Abacinë e Oroshit.

Fatkeqësisht, ashtu si për shumë klerikë e intelektualë të tjerë shqiptarë edhe figura e atdhetarit të madh, Prend Doçi u la në harresë gjatë regjimit diktatorial komunist në Shqipëri. Veprimtaria e atdhetarit të flaktë që luftoi me çdo



mënyrë me penë e me armë për mbrojtjen e territoreve shqiptare, që e pagoi fort shtrenjtë, me arrestimin e pastaj me dëbimin e tij për të mos shkelur në tokën ëmë për disa vite, i cili është një prej rilindësve më të spikatur të kohës, promovues i vlerave atdhetare shqiptare, nuk u vlerësua dhe nuk u mor në konsideratë nga regjimi komunist.

Pas rënies së regjimit komunist, figura dhe veprimtaria e Prend Doçin filloi të trajtohej dhe të shihej me syrin pozitiv duke i dhënë vendin dhe vlerësimin e merituar. Për të është shkruar në revista shkencore, në gazeta të ndryshme, si dhe, i janë kushtuar dy monografi jetës dhe aktivitetit të tij. Në vitin 1997 autori Pal Doçi publikoi monografinë: “Prend Doçi Abati i Mirditës, jeta dhe vepra”, dhe në vitin 2012 në Shkodër u publikua një tjetër monografi nga autori Luigi Martini: “Abati i Mirditës, Prend Doçi (1846-1917)”. Ndërsa në Rrëshen, Mirditë sheshi mban emrin Abat Prend Doçi në nder dhe respekt të



veprës së tij. Mund të thuhet se është cekur dhe trajtuar kontributi i figurës kombëtare Prend Doçi, por mund ta them me bindje të plotë se aktiviteti i tij është më i gjerë sesa është shkruar deri në ditët e sotme, nëse do të hulumtohet nëpër arkivat e huaja të periudhës, kryesisht në ato të Vatikanit, Propaganda Fide, arkivat e Romës dhe të Vjenës do të njiheshim edhe më shumë për veprimtarinë e tij atdhetare e intelektuale.

Për Prend Doçin kanë lënë shënime të shumta edhe autor të huaj që e njihnin shumë mirë rolin dhe veprimtarinë e tij, si, Edith Durham, Franc Nopcia, Antonio Baldacci, Hyacinthe Hecquard, ... si dhe diplomatë të ndryshëm që bashkëpunuan dhe u njohën me aktivitetin atdhetar e klerikal. Ata shprehnin vlerësime dhe konsideratë të lartë për klerikun katolik Prend Doçin, si një prej njerëzve me kontribute të mëdha kombëtare për zhvillimin e shoqërisë e kulturës shqiptare, e vlerësonin për ngritjen e marrëdhënieve të mira me mirditorët dhe për lidhjet e forta me shtëpinë e Gjon Marka Gjonit, si dhe angazhohej nëpërmjet njohjeve e kontakteve që kishte për të rikthyer nga internimi në vendlindje Princin e Mirditës, Preng Bib Doda.

Dom Prend Doçi pasi përfundoi studimet me rezultate të larta në Romë në vitin 1871 u kthye në atdhe. Ai kishte fituar dije dhe kulturë të përgjithshme, jo vetëm në fushën teologjike-klerikale por gjatë qëndrimit në Itali kishte patur mundësi të lexonte libra të ndryshëm filozofik, historik, gjuhësor e kulturor, pasi ishte edhe njohës i disa gjuhëve të huaja. Prej njohësve të kohës, ai njihet si njeri i zgjuar e mendje mprehtë, vizionar e atdhetar i flakte me ndjenja të larta kombëtare shqiptare. Në periudhën që shërbente në Mirditë atij iu shtuan edhe më tepër ndjenjat atdhetarie, për shkak edhe të trysnive të vazhdueshme të pushtuesve. Pak vite pasi u kthye në atdhe, Prend Doçi ishte një prej krerëve që organizoi mirditorët në kryengritjen e vitit 1876-1877. Ai vihet në krye të lëvizjes duke përdorur edhe armën për të luftuar me vendosmëri për mbrojtjen interesave kombëtare e territoriale shqiptare. Por kryengritja u shtyp nga forcat e shumta ushtarake të Perandorisë Osmane dhe autoritetet urdhëruan për të arrestuar shtatë organizatorët, një ndër ta edhe Imzot Prend Doçi. Ai ishte larguar së bashku me Kolë Mark Çunin përmes bjeshkëve të Malësisë së Mbishkodrës për të mos ra në duart e ushtrisë por në malet e Gucisë ata u rrethuan nga ushtria dhe iu kërkua të dorëzoheshin.

Gjatë qëndrimit në burgun e Stambollit,

autoritetet osmane i morën në pyetje dhe i kërkuan nëse kryengritja ishte organizuar nga Preng Bib Doda, në mënyrë që mund të largoheshin nga përgjegjësia e organizimit të lëvizjes së armatosur, por ata e mohuan kategorikisht.

Nga burgu, me ndihmën edhe të Patrikut armen, Prend Doçi i dërgoi një letër patrikut katolik armen në Stamboll, i cili kishte marrëdhënie të mira me Sulltanin Abdyl Hamiti. Patriku armen, Stefan Azarian sapo u njoftua për këtë çështje i kërkoi Sulltanit t'ia falte atij dhe të lironte nga burgu dom Prend Doçin. Kështu pas ndërhyrjeve të Vatikanit, Austro-Hungarisë dhe të patrikut armen në Stamboll u bë e mundur lirimi i Prend Doçit, por me kusht se nuk duhet të kthehej në viset shqiptare. Prend Doçi i falënderoi për nderin e madh që i mundësuan lirimimin e tij nga burgu, dhe shprehte mirënjohje ndaj patrikut armen, autoriteteve të Vjenës dhe të Vatikanit. Ai duhet që të vishte veladonin e priftit dhe të largohet sa më shpejt prej aty, para se Dervish Pasha të kthehej në Stamboll sepse mund të jepte urdhër për ta arrestuar sërish, pasi nuk ia falte organizimin e kryengritjes së mirditorëve. Ashtu ndodhi, sapo Dervish Pasha u kthye, ai u ankua për lirimimin e tij, edhe pse ishte liruar me kusht dhe e kishte të ndaluar për mos kthimin e tij në viset shqiptare.

Në këto kushte dhe rrethana aspak të pëlqyeshme prej tij, por i detyruar që t'i zbatonte dhe dom Prend Doçi do të shërbente si prift jashtë trojeve shqiptare dhe nuk duhet të angazhohej më në lëvizje kryengritëse. Imzot Prend Doçi, do rifillonte jetën në emigrim edhe pse kishte dëshirë të madhe për t'u kthyer në vendlindje. Pas liritimit nga burgu i Stambollit, Prend Doçi shkon në Romë nga ku ngarkohet me detyrën e shenjtë të misionarit ekumenik dhe meshtar në Kanada. Atje shërbeu për disa vite por nuk ka shumë detaje rreth veprimtarisë së tij në Kanada edhe pse Dom Ndoc Nikaj dhe Atë Pashk Bardhi kanë shkruar për aktivitetet dhe formimin e tij, ndërsa rreth veprimtarisë në Kanada nuk gjenden shumë detaje rreth atyre viteve që jetoi dhe veprroi në kontinentin e largët.

Pas 6 viteve në emigrim me mision apostolik, në pranverë të vitit 1883 Imzot Prend Doçi ftohet nga Propaganda Fide të rikthehet në Romë. Sapo kishte mbërritur në Vatikan ai kishte kërkuar të dinte për situatën në viset shqiptare dhe insistonte që t'i jepej e drejta për t'u kthyer në atdhe. Përpjekjet e Sekretarisë së Propagandës Fide pranë autoriteteve osmane në Romë për të lejuar që Imzot Prend Doçi të rikthehet në vendlindje rezultuan të



*Foto e viteve 1915 ne Abacine e Oroshit!
Abat Prend Doçi, At Gjergj Fishta, Marka Gjoni,
Gjon Marka Gjoni, Preng Marka Prenga etj.*

pasuksesshme. Pra, edhe pse sulltani urdhëroi lirimin e tij nga burgu më 1877, Perandoria Osmane vijonte të linte në fuqi dekretin si i dëbuar nga territoret perandorake dhe moslejimin e tij në viset shqiptare. Por, në maj të vitit 1883 Propaganda Fide e dërgoi Imzot Doçin si misionar të saj provizorisht në Tivar të Malit të Zi. Mbërritja në Tivar i mundësonte atij që të ftonte nënën e të afërmit e tij që të shkonin ta vizitonin. Gjatë periudhës që ishte në Mal të Zi ai u prit në audiencë nga mbreti Nikolla i Malit të Zi. Sipas Atë Pashk Bardhit ky takim nuk përfundoi mirë pasi mbreti ishte shprehur “shpresoj së shpejti me shti në dorë Shqypnin, deri në lumin Drin” por përgjigja që i kishte dhënë Imzot Prend Doçi e kishte zëmëruar mbretin Nikolla: “Naltsi, ju ndoshta shtini në dorë krejt Shqypnin, por shqiptarët nuk do t’i keni kurrë miq”. Kjo përgjigje e hidhëroi mbretin Nikolla dhe nuk u prit aspak mirë nga autoritetet malazeze. Për pasojë u morën masa për largimin e tij nga territori i Malit të Zi. Ata kuptuan se ai nuk ishte në anën e tyre dhe qeveria malazeze urdhëroi që Prend Doçi të largohet sa më parë nga territori malazez. Ky veprim nuk u prit mirë sepse atij i interesonte të kishte mundësi të takonte familjarët dhe bashkëkombësit e tij gjatë misionit në Malin e Zi por qëllimi kryesor ishte rikthimi për në vendlindje. Ai përpiquej të shfrytëzonte çdo njohje politike e diplomatike, si në Vatikan, apo në qeverinë e Stambollit për t’u kthyer në vendlindje i lirë. Duke parë që mundësi për t’u

kthyer në vendlindje nuk kishte, Imzot Doçi duhet të pranonte ose një mandat të dytë në Amerikë ose të shkante në Athinë. Në nëntor të vitit 1883 ai pranoi detyrën e sekretarit të arqipeshkvit katolik të Athinës me shpresën se mund të ndryshonte diçka për rikthimin në atdhe. Por edhe nga Greqia nuk arriti të fitojë pafajësinë që e kërkonte me çdo kusht.

Kështu, në gusht të vitit 1884, Propaganda Fide e emëroi Sekretar të argjipeshkvit Antonin Agliardi delegat apostolik i Vatikanit në Indi, që ishte themeluar nga papa Leoni XIII. Por brenda pak muajsh, dom Prend Doçi mbajti postin në krye të misionit diplomatik deri në largimin e tij nga qyteti i Bombejt të Indisë për shkak se Imzot Agliardi duhej të kthehej në Romë për kurime shëndetësore. Pas dy vitesh, në shtator të vitit 1886 ai u kthye në Romë duke e mbyllur me sukses misionin në Indi. Gjatë qëndrimit në Romë i paraqiste Propagandës Fide me kritika të ashpra, pakënaqësitë për situatën në dioqeza dhe të klerit në viset shqiptare. Imzot Doçi synonte në krijimin e klerit shqiptar, organizimin dhe ripërtëritjen e Abacisë së Oroshit. Pas misionit klerikal në emigrim në shtete të ndryshme, që nga Italia, Kanadaja, Mali i Zi, Greqia e India, Prend Doçit në vitin 1888 atij iu realizua dëshira për t’u kthyer në vendlindje me detyrën e abatit të Mirditës -Nullius- (do të thotë se Abacia e Oroshit do të vepronte e pavarur nga dioqezat e tjera, ajo kishte lidhje direkt me Selinë e Shenjtë në Vatikan).

BARTOLOMEU I PRANISHËM GJATË NGJITJES TË JEZUSIT NË QIELL

Më 24. gusht, Shën Bartolomeu (Natanael) apostull

Më 24 gusht Kisha e feston Shën Bartolomeun (Natanaelin) apostull. Emri Bartolomei rrjedh nga fjala arameje "bar-Tôlmay" në gjuhën shqipe do të thotë biri i Tolmajit. I lindur në Kanë të Galilesë në shekullin e parë, e dërgoi te Jezusi apostullin Filip. Ishte një prej dymbëdhjetëve të apostujve dhe emrat e Dymbëdhjetë apostujve janë këta: i pari Simoni, që quhet Pjetër e vëllai i tij Andreu; Jakobi i Zebedeut dhe Gjoni, i vëllai; Filipi dhe Bartolomeu; Toma e Mateu tagrambledhësi; Jakobi i Alfeut dhe Tadeu; Simon Kananeu dhe Judë Iskarioti ai që e tradhtoi (Mt 10, 2-4).

Të veprat e Apostujve është i pranishëm gjatë ngjitjes të Jezusit në Qiell. Kurse të ungjilli i Mateut i Markut dhe i Lukës Bartolomeu është në shoqërinë me Filipin apostull. Ndërsa në ungjillin e Gjonit quhet edhe Natanael (Të nesërmen Jezusi vendosi të shkojë në Galile. Takoi Filipin dhe i tha: "Eja pas meje!")

Filipi ishte nga Betsaida, prej qytetit të Andreut e të Pjetrit.

Filipi takoi Natanaelin dhe i tha: "E gjetëm atë, për të cilin shkroi Moisiu në Ligj dhe Profetët: Jezusin, birin e Jozefit, nga Nazareti." (Gjn 1,45-51). Po ashtu sipas Gjonit në fund të ungjillit paraqet Natanaelin në mesin e nxënësve që Jezusi u tregohet pas ngjalljes në liqenin e Tiberit.

Sipas Euzebit nga Cezareja Shën Bartolomeu pas ngjitjes Jezusit në Qiell shkoi në misione në Indi, ku e lënë kopjen e ungjillit të Mateut. Sipas disa shkrimeve

ai ka mësuar në Mesopotami, Iran, Likoni etj.. Sipas traditës, së bashku me Juden Tade ka predikuar ungjillin (lajmin e mirë) në Armeni (Kisha apostolike e Armene e ka për pajtor). Në shekullin 13 ndërtohet kuvendi (manastiri), ku mendohet se Shën Bartolomeu vdiq i martirizuar në mënyrë më brutale, ku e rijepin për të gjallit dhe ja presin kokën.

Martirizimin e Shën Bartolomeu e pikturoi në kapelën Sikstine në Vatikan: Michelangelo: gjyngji i fundit ku Shën Bartolomeu e mbanë në dorë lëkuren e vetë. Në këtë lëkurë artisti e pikturoi portretin e vetvetes.

Reliktet e Shën Bartolomeu ndërrojnë prej një vendit në vendin tjetër. Fillimisht ishin në Siri, në shekullin e VI barten nga Lindja në Perëndim në ishujt Lipar (në detin Etrusk), pastaj në qytetin Benevent, nga perandori Otoni II i sjell në Romë gjatë vitit 983, ku gjenden në kishën e Shën Bartolomeut. Një pjesë e tjetër të relikteve janë në Frankfurt të Gjermanisë dhe në katedralen e Canterbury në Angli.

Shën Bartolomeun e festojnë përveç Kishës katolike me 24 gusht, edhe Kisha anglikane, Luterane si edhe disa kisha Protestante, kurse kisha Ortodokse e feston me 11 korrik.

Shën Bartolomeu është mbrojtësi i artizanalëve veçanti gjërave që përpunohen nga lëkura, lëkurëpunuesve, barinjve, fshatareve, sëmundjeve e lëkurës si dhe sëmundjet nervore.

Don Nosh Gjollaj






VITRINË LIBRI



Luigj Junçaj

**ITINERARË KATEKUMENALE
PËR JETËN MARTESORE**


**Konferenca I peshkvnore
e Shqipërisë
Tiranë 2024**



Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

**KOLË THAÇI
SHTETAR POET**

**Universiteti i Shkodrës
"Luigj Gurakuqi" - Shkodër 2024**



Dom Ndoc Nikaj

MARCIA

**ONUFRI
Tiranë, 2024**

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVII, nr. 7/8 (580-581) Korrik - Gusht 2024